Linjat e tubacioneve per presionet operuese maksimale te lejueshme mbi 5 bar duhet, qe per te siguruar qendrueshmerine e tyre, operimin dhe mirembajtjen e tyre kundrejt ndikimeve nga jashte, te shtrihen ne nje zone te mbrojtur. Ne zonen e mbrojtur, gjate kohes se ekzistences se linjes se tubacioneve, nuk lejohet te ndertohen obje kte ose te ndermeren nderhyrje te tjera, qe pengojne ose rrezikojne qendrueshmerine, operimin dhe mirembajtjen e tyre. Ndertimi p.sh. i shesheve te parkimit mbi linjen e tubacioneve eshte i lejueshem vetem me miratimin e shoqerise/kompanise. Gjeresia e brezit mbrojtes percaktohet nga shoqeria ne perputhje me diametrin e linjes se tubacioneve si dhe me llojin e masave operuese dhe te mirembajtjes.

Identifikimi formal i nje zone te mbrojtur ne rastet e siperfaqeve te transportit publik (p.sh. rruget dhe kalimet e kembesoreve) mund te zevendesohet nga nje leje zyrtare per shtrirjen e linjave te tubacioneve. Rregulli kontraktual duhet te parashikoje percaktimet per identifikimin e zones apo brezit te zakonshem mbrojtes ne rastin e shfrytezimit te siperfaqes se transportit publik.

Linjat e gazit mund te shtrihen edhe ne hapesirat boshe, si p.sh. kanale ose ura, ne rast se keto hapesira jane mjaftueshmerisht te ajrosura ose te mbushura me rere, ose nese mund te perdoren tubacione me mbeshtjellje, qe perfundojne pertej ketyre hapesirave. Per instalimin e linjave te tubacioneve ne nenkalime dhe pasazhe, p.sh. per kalimin e kembesoreve ose per transportin automobilistik, lejohet te perdoren tubacionet me mbeshtjellje, ne rast se ka ajrosje dhe ventilim te mjaftueshem n atyror.

Linjat e tubacioneve te lira, te aksesueshme, p.sh. ne pasazhe duhet ne rast nevoje te jene te mbrojtura nga nderhyrjet nga jashte. Per linjat e lira, p.sh. nen ose poshte nje ure ose kanali, duhet te mbahet parasysh kodi i praktikave G 414 dhe G 614.

Ne zonat ku mendohet se mund te kete levizje te tokes, e cila mund te rrezikoje sigurine e linjes se tubacioneve te gazit, p.sh. ne zonat e ndikimit te minierave, ne raste te vec;:anta duhet te merren masat e nevojshme te sigurise, p.sh. ne perputhje me kodin e praktikes G 474.

4.2 **Distancat minimale**

4.2.1Te pergjithshme

Ne rastet kur linja e furnizimit shtrihet paralelisht me nje linje tjeter te furnizimit, ose te pajisjeve te tjera te furnizimit, ose ne rast se ato kryqezohen, duhet te respektohet nje hapesire minimale drite per operimin dhe mirembajtjen, si dhe per te menjanuar demtimet nga jashte. Ne rast se keto distanca minimale nuk mund te respektohen, duhet te merren masat e duhura per mbrojtjen e pajisjeve te furnizimit.

Gjate projektimit dhe zgjedhjes se materialeve duhet te merret parasysh afersia e sistemeve me <;:lirim nxehtesie (si p.sh. linjat e ngrohjeve ne distance ose e kabllove te energjise)

4.2.2Distancat minimale te linjave te gazit nga linjat e furnizimit/shkarkimit ose nga ndertesat

Distancat minimale te linjave te gazit ne ndertimet e hapura nga linjat e tjera te tubacioneve dhe ndertimeve te ndryshme nuk duhet te tejkaloje:

- gjate kalimeve paralele, gjysmen e diametrit te jashtem te linjes se tubacionit mete madh, por jo me pak se 0,2 m,

- 0,1 m gjate kryqezimeve

Gjate ndertimeve te linjave pa kanale duhet te merren parasysh pervec;: ketyre distancave edhe tolerancat e kushtezuara nga terreni dhe proc;:edurat e operimit.

4.2.3 Distancat minimale nga kabllot

Distancat minimale te linjave te gazit nga kabllot energjetike ne germimet e hapura, pa masa te vec;:anta mbrojtese, nuk lejohet te kalojne vlerat e meposhtme:

- Presioni operues maksimal i lejueshem deri ne e perfshi 5 bar:
  gjate kalimeve paralele 0,2 m dhe
  gjate kryqezimeve 0,1 m.

- Presioni operues maksimal i lejueshem me imadh se 5 bar:
  gjate kalimeve paralele 0,4 m dhe
  gjate kryqezimeve 0,2 m.

Rritja e distancave ne diapazonet e presionit maksimal operues te lejueshem me te madh se 5 bar nuk sherben per mbrojtjen nga ndikimet ne operimin normal. Ne kete rast jane te mjaftueshme distancat si ne presionin operues maksimal te lejueshem deri ne e perfshi 5 bar. Ato i sherbejne venies ne dispozicion te nje hapesire te mjaftueshme pune per punimet e nevojshme ne linjat e tubacioneve.

Ne rastet kur distancat per mbrojtjen nga ndikimet ne operimin normal nuk mund te respektohen, duhet qe per mbrojtjen e linjave te gazit te parashikohen masat e nevojshme, p.sh. vendosja e shtresave ose e pllakave qe rregullojne shkembimin e nxehtesise. Keto masa ne rast nevoje duhet te koordinohen me operuesit e kabllove.

Gjate ndertimit te linjave pa kanale duhet te merren parasysh pervec;: ketyre distancave edhe tolerancat e kushtezuara nga terreni dhe proc;:edurat e operimit.

4.2.4 Distancat nga linjat e lira te tensionit te larte, trenat elektrike dhe impiantet e energjise se eres

Distancat ne rastet e kryqezimeve dhe linjave paralele nga linjat e lira te tensionit te larte duhet qe te respektohen ne perputhje me kodin e praktikave GW 22.

Ne rastet e linjave paralele dhe te kryqezimeve te linjave te tubacioneve me linjat e tensionit te larte ose me trenat elektrike duhet te gjendet vlera qe krijohet nga ndikimi i rrymes alternative. Ne rast nevoje duhet te merren masat ne perputhje me kodin e praktikave GW 22 per sigurimin e mbrojtjes kundrejt tensioneve te palejueshme te prekjes dhe ne perputhje me kodin e praktikave GW 28 per mbrojtjen kundrejt korrozionit shkaktuar nga rryma alternative.

Distancat nga impiantet e eres duhet te percaktohen duke iu referuar nje rreziku te mundshem mekanik te linjes. Ne rast te ndikimeve elektrike distancat mund te percaktohen ne perputhje me kodin e praktikave GW 22.

4.3 **Tubat dhe komponentet e linjave te tubacioneve**

Linjat e tubacioneve duhet te projektohen minimalisht per presionin operues maksimal te lejueshem. Tubat dhe komponentet e tjere te linjave duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te standardit SSH EN 12007-3. Per impiantet, per te cilat jane te nevojshme sasi te vogla tubash, mund te perdoren pervec;: tubave sipas standardit SSH EN 12007-3 edhe tuba ne perputhje me kapitullin perkates te aplikueshem te standardit SSH EN 10216 ose SSH EN 10217. Edhe tubat nga fusha e perdorimit te kodit te praktikave G 463 i permbushin kerkesat teknike per linjat e tubacioneve deri ne 16 bar.

Per te gjithe komponentet nen presion, te nje linje te tubacioneve duhet qe vetite te c;:ertifikohen nepermjet nje c;:ertifikate pranimi 3.1. sipas standardit SSH EN 10204.

4.4 Valvolat bllokuese dhe pajisjet shfryrese

Montimi i valvolave bllokuese kryhet ne perputhje me kerkesat e furnizimit dhe te kushteve ne vend. Per linjat e tubacioneve te gazit me presion operimi mete madh se 100 bar duhet te parashikohen pajisje, te cilat sherbejne per te nxjerre nga operimi zonate caktuara te rrjetit te tubacioneve ose per te ulur presionin e operimit.

Per linjat e tubacioneve me presione operuese maksimale te lejueshme me te medha se 5 bar duhet te parashikohen pajisje shfryrese ne vende te aksesueshme.

Valvolat bllokuese duhet te regjistrohen ne perputhje me standardet SSH EN 331 dhe SSH EN 13774.

4.5 **Sigurimi i presionit**

Nuk lejohet te tejkalohet presioni operues maksimal i lejueshem ne linjen e tubacioneve te gazit. Per sigurimin e presionit, vec;:anerisht ne lidhje me tejkalimin e presionit operues maksimal te lejueshem, duhet te merret parasysh kodi i praktikave G 491.

4.6 **Mbrojtja nga korrozioni**

Linjat e tubacioneve te gazit dhe mantelet/mbeshtjelljet e tubove prej c;:eliku duhet te kene nje mbrojtje nga korrozioni ne perputhje me ngarkesat e pritshme mekanike dhe korrozive. Kjo mbrojtje perbehet nga nje mbeshtjellje ne forme tubi (mbrojtje pasive) dhe ne rast nevoje nga mbrojtja katodike shtese nga korrozioni (mbrojtja aktive) per tubat e produktit.

4.6.1 Mbrojtja pasive nga korrozioni.

Si rregull te gjitha pjeset e linjave te tubacioneve permbajne nje mbeshtjellje (nga prodhimi) prej polietileni, polipropileni (SSH EN ISO 21809-1) ose nje shtrese me baze epoksidi ose poliuretani (SSH EN 10289 dhe SSH EN 10290). Respektimi i kushteve perkatese teknike te furnizimit c;:ertifikohet nepermjet c;:ertifikates se prodhimit 2.2. sipas standardit SSH EN 10204.

Te gjitha pjeset e linjave te tubacioneve qe nuk kane nje mbeshtjellje nga fabrika duhet te vishen me nje mbeshtjellje prej fashoje ose materiale shtrenguese ne perputhje me standardet SSH EN 12068, perkatesisht me klasat e ngarkesave B ose C, ose me nje mbeshtjellje minimalisht po aq te vlefshme ne perputhje me standardet SSH EN 10289, SSH EN 10290. Personeli i ngarkuar me punimet e mbeshtjelljeve duhet te mbaje deshmine e vlefshme sipas udhezimit GW 15.

Valvolat duhet te mbrohen nga korrozioni. Per valvolat qe jane veshtire te mbeshtillen, bashkimet me fllanxha ose rakorderite mund te perdoret edhe material mbeshtjellje sipas klases Ate ngarkeses, ne perputhje me standardin SSH EN 12068, ne rast se vendoset dhe nje mbrojtese shtese e jashtme (p.sh. tapet per mbrojtjen e tubit), per ta mbrojtur nga ngarkesat mekanike.

Materiali mbeshtjelles duhet te jete i pershtatshem per temperaturat e pritshme te murit te tubit, por minimalisht per 30°C.

Ne rast se kemi ngarkesa mekanike me te medha (p.sh. nga perberja e materialit te shtratit te tubit) dhe duke marre parasysh kushtet ne terren, duhet te perdoret nje mbeshtjellje e tubit, veyanerisht e forte e rezistente, ose te merren masa shtese (p.sh. veshje me llac; c;imentoje sipas kodit te praktikave GW 340) te nevojshme. (shiko edhe
5.12)

Segmentet e linjave mbi toke duhet te mbrohen ne menyren e duhur kundrejt ndikimeve korrozive, p.sh. nepermjet lyerjes ose mbeshtjelljes. Lyerja duhet te kryhet ne perputhje me standardin SSH EN ISO 12944. Mbeshtjellja duhet te mbrohet gjithashtu ne rast nevoje edhe kunder ndikimeve te rrezatimit ultraviolet UV (p.sh. nepermjet mbulimit).

4.6.2Mbrojtja aktive nga korrozioni

Mbrojtja katodike nga korrozioni duhet te parashikohet per linjat e tubacioneve te gazit me nje presion operimi maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar. Per linjat e gazit me nje presion operimi te lejueshem me te vogel ose te barabarte me 5 bar duhet te perdoret mbrojtja katodike ne perputhje me standardin SSH EN 12954-2004, nese eshte e dallueshme nje rritje e rrezikut te korrozionit si shkak i nje ndikimi elektrokimik.

Rreziku i shtuar nga korrozioni ekziston ne rastet kur:

- Formohet nje element kimik me katoda te huaja (kemi nje linje paralele)

- Ne rastet e rrymave te humbura te shkaktuara nga impiantet e rrymes se vazhduar

Per pjeset e linjave me presione operimi mbi 5 bar ose ne rastet e ndikimeve elektrokimike, ne rast se mbrojtja katodike nga korrozioni nuk eshte e mundur ose teknikisht nuk ka kuptim, duhet te perforcohet mbrojtja pasive nga korrozioni.

Gjate projektimit, ndertimit dhe venies ne pune te mbrojtjes katodike nga korrozioni, duhet te mbeshtetemi ne standardet SSH EN 12954 dhe kodet e praktikave GW 10, GW 12, GW 16 dhe G 412.

Ndikimet elektrokimike (p.sh. bashkimet metalike me bazamentet) duhet te perjashtohen nepermjet masave perkatese (p.sh. shtresa te ndermjetme izoluese).

4.7 Ndertimet pa kanale, germimet pa hapesire pune te kalueshme

Per ndertimet pa hapesira pune te kalueshme (rehabilitimi, renovimi, nderrimi itubove dhe instalimet e reja) duhet te sigurohet, qe te mbahen parasysh kerkesat teknike te ketij kodi te praktikave, ve9anerisht ne lidhje me distancat minimale dhe shtresat mbuluese minimale. Ne rastet e ndertimeve pa kanale duhet te merren parasysh kodet e praktikave GW 304, GW 320-1, GW 320-2, GW 321, GW 322-1, GW 322-2, GW 324 dhe GW 325 si dhe udhezimi GW 323.

4.8 Dokumentacioni i konstruksionit/ndertimit

Per zbatimin e punimeve, ne rast se nuk disponohen dhe eshte e nevojshme, duhet te hartohen planet e vendosjes dhe te punimeve.

5 Ekzekutimi i punimeve

5.1 Brezi i punes

Perpara fillimit te punimeve duhet te percaktohet nje brez, i cili sherben si zona e punes per ndertimin e linjes se tubacioneve te gazit. Brezi i punes duhet te jete ne perputhje ve9anerisht me diametrin e linjes, llojin dhe sasine e germimeve dhe makinerite qe do te perdoren. Linjat e furnizimit qe ndodhen ne brezin e punes nuk duhet te rrezikohen. Per kete duhet te tregohet kujdes duke respektuar udhezimin GW 315 (Udhezuesi per masat e mbrojtjes se pajisjeve per furnizimin gjate punes ndertimore) veyanerisht ne kryqezime dhe ne kalimet paralele dhe ne rast nevoje te merren masat e nevojshme (p.sh. 9arje terthore, puset/germimet e hapura me krahe).

5.2 Transportimi dhe magazinimi i tubove.

Ne menyre qe te mbrojme tubat nga demtimet, duhet qe ngarkimi dhe shkarkimi i tyre te behet me pajisje te ve9anta, si dhe gjate transportit, ne rast se eshte e nevojshme, te ndahen me shtresa te ndermjetme dhe te sigurohen kundrejt ndikimeve demtuese, si p.sh. zhvendosjet, varjet dhe lekundjet.

Lartesite e stivave ne magazinimet duhet te zgjidhen ne menyre te tille, qe te menjanohen demtimet e tubave. Stivat e tubave duhet te sigurohen nga rrokullisjet e mundshme.

Tubat e 9elikut te mbeshtjella me polietilen (PE), ne rast te magazinimeve per nje kohe te gjate, duhet te mbrohen kundrejt rrezatimit direkt te rrezeve te diellit, ne perputhje me te dhenat e prodhuesit.

Skajet e tubave duhet te mbahen te mbyllur deri ne pergatitjen dhe ne prodhimin e bashkimeve.

5.3 **Mbulesat minimale (shtresat mbuluese minimale)**

Lartesia e mbulimit te tubacioneve duhet te pershtatet sipas kushteve ne terren. Linja e tubacionit te gazit si rregull per nje presion operimi maksimal te lejueshem deri ne 5 bar duhet te mbulohet me nje trashesi 0,6 m deri ne 1 m, per nje presion operimi maksimal te lejueshem mbi 5 bar nga 0,8 m deri ne 1 m. Mbulimi ne pikat me kufizime lokale, pa masa te ves;anta mbrojtese mund te zvogelohet deri ne 0,5 m per nje presion operimi maksimal te lejueshem deri ne 5 bar ose deri ne 0,6 m per nje presion operimi maksimal te lejueshem mbi 5 bar, per sa kohe qe nga kjo nuk pritet ndonje ndikim i palejueshem tek linjat e tubacioneve te gazit. Kjo shtrese nuk duhet ti tejkaloje 2,0 m pa ndonje arsye te ves;ante. Ne rast te tejkalimit ose mosarritjes se tyre duhet te merren parasysh ndikimet statike, perllogaritjet mund te kryhen sipas standardit dhe legjislacionit ne fuqi mbi: "Perllogaritjen statike te tubove te s;elikut te instaluar nen toke, linjat e tubacioneve ne distance".

Per devijimet qe dalin jashte ketyre percaktimeve duhet te merren ne rast nevoje masa te nevojshme (p.sh. tub mbrojtes, pllaka betoni, mure mete trasha te tubave).

5.4 **Kanalet e tubacioneve dhe germimet/transhete e nevojshme (pusetat e valvolave)**

Kanalet e linjave te tubacioneve dhe germimet e nevojshme duhet te kryhen mbi bazen e diametrit te jashtem te tubit dhe te permasave te komponenteve te tjere, ne perputhje me standardin perkates (DIN 4124 - Excavations and trenches - Slopes, planking and strutting breadths of working spaces).

Per menjanimin e tensioneve te palejueshme ne linjat e instaluara te tubacioneve, bazamenti i kanalit duhet te germohet ne menyre te tille, qe linja e tubacionit te shtrihet plotesisht.

Ne rastet e terreneve qe nuk kane aftesi mbajtese ose me permbajtje te larte uji, linja e tubacioneve te gazit, ne rast nevoje duhet te sigurohet nga forcat kundervepruese.

Ne segmentet e pjerreta te trasese se linjes duhet te merren masa kundrejt efekteve te drenazhimit te kanalit te tubave. Ne shpatet e maleve duhet te merren masat e duhura per te penguar rreshqitjet e tokes dhe te linjes se tubacioneve.

5.5 **Bashkimet e tubave**

Tubat dhe pjeset e tjera te linjes se tubacioneve duhet qe parimisht te bashkohen me saldim.

Jane te lejueshme edhe llojet e tjera te bashkimeve, per sa kohe qe mund te deshmohet nepermjet eksperiences se operimit ose testimeve, qe bashkimet e zgjedhura jane ne perputhje me kerkesat teknike minimale te bazave testuese te krahasueshme si dhe ju pergjigjen kerkesave teknike operuese ne lidhje me qendrueshmerine dhe hermeticitetin.

5.6 Punime me saldim

Punimet me saldim duhet te kryhen ne perputhje me kodet e praktikave GW 350 dhe SSH EN 12732.

5.7 Regjistri i tubacioneve

Ne rastet e presionit operues maksimal te lejueshem me te madh se 5 bar duhet qe perve9 punimeve me saldim dhe shtrimit te linjes, ne kuadrin e ecurise se punimeve te mbahet dhe nje regjister i tubacioneve (per shembullin e regjistrit te tubacioneve shiko shtojcen B dhe C).

5.8 Kendet e perkuljes

Perkuljet elastike te linjave te tubacioneve jane te lejueshme, ne rast se kendi perkuljes nuk eshte me ivogel se:

$$R_{mm} = \frac{206 \times S \times O}{Rto,s}$$

ose

$$R_{mm} = \frac{300 \times D}{!0,5} \quad (\text{kurS= 1 5})$$

Ku kemi:

$R_{m;n}$ = rrezja me e vogel ilejuar iperkuljes ne m

$R_{I\ 0.5}$ = kufiri minimal i terheqjes ne N/mm^2

S = koeficienti isigurise

D = diametri i jashtem ne mm

5.9 Harku i tubit

Ne rast se duhet te realizojme kend perkulje me te vogel se ai ilejuar sipas kapitullit 5.8, duhet te montohen ose harqet e prodhuara ne uzinen furnizuese (harqe te prodhuara) ose tubat e harkuar ne kantjer ne menyre te ftohte. (harqet e kantjerit)

Ne rastet e harqeve te kantjerit te ndertimit per tubat me tegela saldimi gjatesore, duhet qe tegeli isaldimit te jete ne zonen me pak te tensionuar per perkulje/harkim.

Harqet me palosje nuk jane te lejueshme. Prerjet me kend jane te lejueshme duke marre parasysh kodin e praktikave GW 350.

Per prodhimin e harqeve ne kantjerin e ndertimit (shiko standardin mbi "prodhimin dhe testimin e tubave te harkuar ne gjendje te ftohte per linjat e largeta, linjat e tubacioneve ne distance") duhet te perdoren makineri perkuljeje (kalandra). Per harqet deri DN 300 mund te perdoren edhe presa per perkulje tubi apo stampa. Per harqet ne kantjerin e ndertimit duhet qe perkulja maksimale nuk duhet te kaloje 1,5• ne nje

gjatesi sa diametri i tubit dhe rezja te mos jete me e vogel se 40-fishi i diametrit te jashtem te tubit. Diferenca midis diametrit maksimal dhe minimal ne zonen e perkuljes duhet qe mundesisht te jete e vogel, por jo me e madhe se 4 % e diametrit te jashtem.

$$\frac{2 \times (D_{max} - D_{min})}{(D_{max} + D_{min})} \leq 0{,}04$$

Gungat dhe palosjet nuk jane te lejueshme. Valezimet e sheshta mund te jene te pranueshme. Ne rast nevoje mund te perdoret nje mandrel.

5.1 OTestimi i mbeshtjelljes

Perpara se te vendoset segmenti i linjes se tubacionit ne kanalin e vet duhet te kontrollohet mbeshtjellja e tubit dhe mbeshtjellja e komponenteve me nje aparat testues elektrik, per te identifikuar pikat me defekt. Testimi duhet te kryhet me nje shpejtesi te tille, qe te mundesoje nje percaktim sa mete lehte te pikave me defekt.

Tensionet e testimit per materialet e perdorura mund te merren nga standardet perkatese te mbeshtjelljeve. Pikat me defekt duhet te korrigjohen ne menyren e duhur ne perputhje me udhezimin e GW 14. Mbas korrigjimit te pikave me defekt duhet te kryhet nje testim iri.

Per linjat e tubacioneve qe dalin/shkeputen nga siperfaqja e tokes, gjate kalimit toke/ajer duhet te testohet mbeshtjellja e jashtme per te shmangur demtimet nga korrozioni.

5.11 Shtrimi i linjes se gazit

Tubat dhe pjeset e tjera te linjes se tubacioneve te gazit ne rast nevoje duhet te pastrohen nga jashte dhe nga brenda perpara se te vendosen ne kanalin e tubave, si dhe te kontrollohen per demtimet nga transporti dhe nga magazinimi. Ne rast se ka nderprerje te punimeve duhet te sigurohet, qe te mos depertoje uje apo lende te tjera ne linje.

Per zhytjen e tubave dhe segmenteve te tubave te ve<;:ante ne toke, duhet qe sipas nevojes te kete pajisje ngritese ne numer te mjaftueshem, te cilat garantojne nje ulje te njetrajtshme dhe pa goditje te tubave, pa kaluar limitin e lejueshem te harkut te perkuljes. (shiko kapitullin 5.8) Ve<;:anerisht duhet te sigurohet, qe te mos lindin deformime plastike te segmentit te tubit. Per mbrojtjen e tubave duhet te perdoren mjete ndihmese te pershtatshme (p.sh. rripa ose rrula).

5.12 Mbushja e kanalit te tubit

Mbushja duhet te kryhet brenda nje kohe te shkurter mbas vendosjes se linjes se gazit.

Linja e tubacioneve e instaluar duhet te jete e rrethuar nga te gjitha anet me nje trashesi shtrese te mjaftueshme me material dheu, perberja e madhesise se kokrrizave te te cilit duhet te jete e pershtatshme ne lidhje me rezistencen mekanike te tubave per krijimin e shtrati te pershtatshem per linjen e tubacioneve te gazit. Ne rast se keto kushte nuk mund te plotesohen, duhet te merren masa te ve<;:anta ne

perputhje me kapitullin 4.6.1. Ne pergjithesi materiali i nxjerre nga germimi mund te perdoret perseri per mbushjen e kanaleve te mbetura.

Ne rast se behen thellime te metejshme te nivelit te kanalit duhet qe linja e tubacionit te kete nje shtrese te poshtme, ne menyre qe te mund te menjanohen tendosjet e palejueshme.

5.13 Linja nenkaluese (Culvert)

Ne rastet e kryqezimeve te vijes se ujit me tubacionin nenkalues (Culvert), trasheja e linjes (trasheja e nenkalimit) duhet te konstruktohet dhe pozicionet ne menyre te tille qe te mos ndodhe permbytje deri ne vendosjen ose gjate vendosjes se tubacionit te nenkalimit. Perpara vMdosjes se linjes nenkaluese duhet te percaktohet gjendja e transhese se nenkalimit dhe thellesia e bazamentit te kanalit nepermjet testimit te thellesise. Ne varesi te proc;:edures se realizimit te linjes nenkaluese dhe ne baze te ngarkesave te pritshme te linjes si dhe te mbeshtjelljes se tubit te saj, para shtrimit duhet te pajiset me nje mbrojtese shtese, qe ne rast nevoje mund te veproje edhe si nje mbrojtese kundrejt forcave kundervepruese.

Ne rastet e rrymave te ujit me trafik ujor si dhe ndaj nje shpelarje te mundshme te linjes nenkaluese (gerryerje e shtreses mbushese) rekomandohet, qe te merren masa te pershtatshme mbrojtese, p.sh. te sigurohet linja nenkaluese teresisht ose pjeserisht me shtresa guri.

5.14 Avancimi i tubit

Avancimi i tubit duhet te kryhet sipas metodes se percaktuar ne kodin e praktikave GW 304 ose te nje metode tjeter te pershtatshme. Duhet te mbahet parasysh, qe te shmangen demtimet e mbeshtjelljeve. Duhet te merren parasysh dhe fundosjet e mundshme te tokes. Gjate aplikimit te nje proc;:edure shpim-shpelarje horizontale te drejtuar sipas kodit te praktikave GW 321.

Ne rast se tubi avancues do te perdoret si tub produkti, duke marre parasysh llojin e tokes dhe nepermjet zgjedhjes se pajisjeve qe dote perdoren duhet te sigurohet, qe te mos lindin demtime te papranueshme te mbeshtjelljes se tubit dhe te murit te tubit. Kjo kryhet mbas percaktimit te avancimit te tubit nepermjet vrojtimit te daljes se fundit te tubit dhe nepermjet matjes elektrike ne perputhje me kodin e praktikave GW 20 dhe GW27.

5.15 Montimi i pajisjeve bllokuese

Gjate montimit te valvolave duhet te sigurohet, qe te mos lindin ngarkesa/tensione te papranueshme, ne rast nevoje duhet te mbrohen kundrejt fundosjes ose perdredhjes.

5.16 Marktimi/shenjimi dhe matja

Linjat e gazit duhet te maten dhe te shenohen ne inventarin publik sipas standardit perkates (DIN 2425-1, Plans for public supplies, for water engineering and for transmission lines; plans for public pipe systems for gas and water supply), (DIN 2425-3, Plans for Public Utilities, Water Resources and Long-distance Lines; Plans for Long-distance Pipelines) si dhe sipas kodit te praktikave GW 120. Vendndodhja e pajisjeve

te nevojshme bllokuese per operim duhet te shenohet/marktohet me tabela sinjalizuese ne perputhje me standardin perkates (DIN 4065, Gas pipelines indicating labels dhe 01N 4069, Gas distribution grids indication labels). Jashte zonave te ndertuara, ne perputhje me ecurine e trasese dhe te kushteve aktuale ne terren, duhet te shenohen me tabela , shigjeta dhe gure dallues pikat e ve9anta te orientimit, si p.sh. pikat e thyerjes se linjave ose kryqezimet.

5.17 Linjat e tubacioneve mbi toke

Per ndertimin e linjave te tubacioneve mbi toke duhet te respektohen kodet e praktikave G 414 dhe G 614.

6 Testimi nen presion ne linjat e tubacioneve te gazit

6.1 Te pergjithshme

Pas mbushjes se kanalit te linjes se tubacioneve duhet qe para venies ne pune linja e gazit ti nenshtrohet nje testimi ne presion te pergjithshem ose me segmente te caktuara, ne perputhje me proyedurat e pershkruara me kodin e praktikave G 469.

Eshte e rekomandueshme qe ndertimet e ve9anta dhe segmentet e linjave mbitokesore, perpara se te montohen t'i nenshtrohen nje testimi te ve9ante nen presion.

Shoqeria e ngarkuar me kryerjen e testimit nen presion duhet te perdore personel te mjaftueshem te kualifikuar, te besuar dhe te trajnuar.

Qe nga fillimi i venies nen presion deri ne uljen e presionit mbas perfundimit te testimit nuk jane te lejueshme punimet ne linjen e gazit dhe ne zonat e aferta te linjes, per sa kohe qe nuk behet fjale per masa, te cilat jane te paevitueshme per kryerjen e testimit nen presion.

Mbas perfundimit te nje testimi nen presion me ajer duhet qe presioni te ulet ne menyre te kontrolluar dhe pa rrezik nepermjet pajisjeve te pershtatshme shfryrese.

6.2 Pro edurat

Per nje presion operimi maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar mund te perdoret vetem proyedura e matjes se presionit me lende testuese uje (B 2) ose proyedura e matjes pneumatike pre9ize te presionit (C 3).

Per nje presion operimi maksimal te lejueshem me te vogel ose te barabarte me 5 bar lejohet te perdoret metoda e matjes se presionit me lende testuese ajer (B 3).

Ne rast se kemi nje gjatesi linje deri ne 500 m lejohet te perdoret metoda e inspektimit vizual me ajer (A 3) ose metoda e inspektimit vizual me uje (A 2).

Ne rast se nuk ka mundesi tjeter, p.sh. ne bashkimet, mund te perdoret metoda e inspektimit vizual me gaz me presion operues (A 4).

7 <;ertifikata e pranimit

Ne lidhje me rezultatin e testimit, leshojne nje 9ertifikate pranimi:

- Specialisti teknik per linjat e tubacioneve me nje presion operimi maksimal te lejueshem mete vogel ose te barabarte me 5 bar dhe ,

- eksperti teknik per linjat e tubacioneve me nje presion operimi maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar.

Ne 9ertifikaten e pranimit (shiko Shtojcen A) mbikqyrsi i punimeve dhe drejtuesi i tyre konfirmojne, shtrimin sipas rregullave te linjave te tubacioneve te gazit ne perputhje me percaktimet e ketij kodi te praktikave. Gjithashtu personeli ikualifikuar (specialisti teknik, eksperti teknik) konfirmojne se rezultatet e testimeve nen presion te krye ra nuk kane asnje objeksion/rezerve ne lidhje me venien ne pune te segmentit te linjes se testuar me presionin operues maksimal te lejueshem.

8 Venia ne pune

Kur eshte e nevojshme, linja perpara se te vihet ne pune duhet te pastrohet dhe ve9anerisht ne rast se i eshte nenshtruar nje testimi nen presion me uje, duhet te thahet me nje proqedure te pershtatshme. Shkalla e tharjes varet nga kushtet e parashikuara te operimit (p.sh. lloji, temperatura dhe presioni i gazit).

Para se te leshohet gazi ne linje duhet te konstatohet se linjat e lidhjes ne rrjet jane te mbyllura hermetikisht dhe nuk mund te rrjedhe gaz i pakontrolluar. Pastaj linja duhet te mbushet me gaz dhe te vendoset ne operim duke respektuar kodin e praktikave G 465-2 ose G 466-1. Ne rast se eshte e nevojshme duhet te hartohet nje udhezim me shkrim ipro<;edures.

9 Dokumentacioni

Dokumentacioni perbehet si me poshte nga:

- Skicat e rregjistrimit
- Skicat dhe te dhenat teknike sipas kodit GW 120
- <;ertifikata e pra nimit
- Protokollet e testimit nen presion
- Libri itubacioneve
- Deshmite e testimit per tubat dhe rakorderite e tubave
- Protokolli itestimit te mbeshtjelljes

Dokumentacioni duhet te jete idisponueshem gjate gjithe kohes se operimit te linjes.

Shtojca A (informative) -Shembull / Certifikata e pranimit

Mbi testimin e nje linje gazi me nje presion operues maksimal te lejueshem deri ne 5/16 bar sipas kapitullit 7 te kodit te praktikave G 462.

Kontraktuesi: ----------

2 Emertimi i linjes ----------

3 Emertimi i segmentit te linjes: ----------

4 Te dhena mbi segmentin e linjes

4.1 Gjatesia: ----------

4.2 Diametri: ----------

4.3 Presioni operues i lejueshem: ----------

4.4 Lloji i tubit: ----------

4.5 Materiali i tubit: ----------

4.6 Permasat: _____

4.7 Mbeshtjellja: ----------

4.8 Bazat e testimit: p.sh. G 462 (A)

5 Te dhena ne lidhje me punimet e shtrimit dhe saldimit

5.1 Shoqeria zbatuese: ----------

5.2 Numri i tegelave te saldimit: ----------

5.3 Numri i tegelave te testuar pa shkaterrim: ----------

5.3.1 Testuar nga: ----------

5.3.2 Vleresuar nga: ----------

5.4 Punimet e shtrimit dhe saldimit jane mbikeqyrur nga ----------

---

6 Testimi i linjave te shtruara

Testimi i linjave te shtruara te gazit sipas kapitullit 7 te kodit te praktikave G 462 eshte kryer me sukses metoda e testimit nen presion

_____

(Emertimi i sakte i metodes se testimit nen presion)

ne perputhje me kodin e praktikave G 469.

Shenime: _____

_____

Mbi bazen e testimit te kryer konfirmohet, se nuk ka asnje objeksion kunder venies ne pune te linjes se gazit me presion operues te lejueshem.

_____

(Specialisti teknik/Eksperti teknik) Date

Shtojca B (informative) -Model i nje regjistri te tubacioneve

Libri i tubacioneve (Kopertina me _____shtojca)

Per linjen Segmenti

Ndertuar sipas kodit te praktikave G 462

Gjatesia e pergjithshme e linjes se gazit_____m; Gjatesia e segnnentit te testuar:_____m

Diannetri (ON) Presioni nominal (PN)_____Presioni operues i lejueshem_bar Lloji i testimit nen presion

Presioni i testimit te gjetur nga vlerat e matjeve ne piken e larte:_____bar; ne piken e ulet: _____bar

Lloji i mbeshtjelljes se tubit

Punimet e saldimit dhe shtrirjes nga shoqeria: Ne

periudhen nga deri

Mbikqyrja e saldimit nga:

Metoda e saldimit	Shtresat e saldimit	Materiali shtese	Diametri	henime
	Shtresa rrenje			
	Shtres mbushese			
	Shtresa mbuluese			

Saldatori:

Mbiemri, Emri	Metoda, Shtresa e saldimit	Mbiemri, Emri	Metoda, Shtresa e saldimit

Shenime: _____

Testimet pa shkaterrim te tegeleve te saldimit nga shoqeria:

Tegelet e saldimit ne linje	Ekzaminimi radiografik	rrestimet UT	h enime
Cope= 100%	%	%%	

Janemarre cope tegele testuese nga linja e gazit

Sheninne _____

Vendi	Data:	Nenshkrimi i mbikqyrjes se punimeve

Shtojca C (informative) -Shembull - librii tubacioneve

Emrii Ekzkutuesit te punimeve/Operatorit:	linja e gazit Nr i lin &slkom1sionit:	Segment :	Libn itubacioneve-faqja:

Nr itubit.	PjcsCtc montuara•	PCrmasat c b.Jbit		Matcriali	Prodhuesi	Nr. iporosisC	GjatCsia (m)	Nr. serial i tegelit	Salduar f'l'lC	Tcgcli i saldimit		ShCnimo
		da lmm\	S lmm\							pare	testuar UT/Xrav	
Shuma						Shuma			Shuma			
						Shuma permbledhese	r--- ------		Shuma permbledhese			

Tubaldhe pjeset e tjera te linjes se tubacioneve u montuan ne gjendje te mire

Tegelat rrehore te saldimit dhe mbashtjellje t e tubave testuar dhe pa defekte

Date:------Per shoqerine:----------

Date:------ Mb keqyrja e punimeve _____

• d.m.th. Rakorderi, vatvota, tuba mb9shtje118se, b9rryla te fabrkuar (me prodhuesin, perrmasat, nr. 1 fabrik1mit.), b9rryta kantjeri etj.

10 Bibliografi

10.1 Kodet e Praktikave te DVGW

G 100 (A), Kerkesat teknike per kualifikimin e eksperteve teknike per furnizimin me gaz

G 260 (A, Cilesia e gazit

G 412 (A), Mbrojtja katodike nga korrozioni irrjeteve te shperndarjes se gazit dhe linjave te shperndarjes se gazit te instaluara nen toke

G 414 (A), Linjat e gazit te instaluara nen toke.

G 465-2 (A), Linjat e gazit me nje presion operimi deri 5 bar-Riparimet.

G 466-1 (A), Linjat e gazit me tuba 9eliku per nje presion operimi mbi 5 bar; mirembajtja

G 469 (A), Metodat e testimit nen presion per transmetimin e shperndarjen e gazit

G 474 (H). Masat per operimin e sigurt te linjave te tubacioneve te gazit ne zonat te influencuara nga aktivitetet minerare.

G 491, Impiantet e rregullimit te presionit te gazit per presionet hyrese deri ne e perfshi 100 bar; projektimi, fabrikimi, ndertimi, testimi, komisionimi dhe operimi.

G 614 (A), Linjat e gazit te instaluara ne ndertimet/zonat industriale, mbas pikes se hyrjes.

GW 10 (A), Mbrojtja katodike nga korrozioni (KKS) e eneve depozituese nen toke dhe linjave te tubacioneve prej 9eliku- komisionimi dhe monitorimi

GW 12 (A), Projektimi dhe ndertimi i impianteve te mbrojtjes katodike nga korrozioni per rezervuaret magazinues dhe linjat e tubacioneve prej 9eliku, te shtrira nen toke.

GW 14 (M), Riparimi idemtimeve ne mbeshtjelljet e mbrojtjes nga korrozioni te tubave dhe te komponenteve te linjave te tubacionit te materialeve prej hekuri.

GW 15 (M), Ri-mbeshtjellja e tubave, armaturave, valvolave dhe rakorderive; plani trajnimeve dhe testimit.

GW 16 (A), Mbrojtja katodike nga korrozioni (MKK) e eneve depozituese nentokesore dhe linjave te tubacioneve prej 9eliku - monitorimi ne distance.

GW 20 (A), Mbrojtja katodike nga korrozioni ne zonat e kufizimit me rruget e transportit, tubat e prodhuar prej 9eliku me metoden avancuese.

GW 22 (A), Masat gjate ndertimit dhe operimit te linjave te tubacioneve ne fushat e ndikimit te impianteve energjetik me tension te larte dhe trenave me rryme alternative.

GW 27 (A), Proyedura per deshmine e efektshmerise se mbrojtjes katodike nga korrozioni ne linjat e tubacioneve te instaluara nen toke.

GW 28 (A), Vleresimi irrezikshmerise se korrozionit te shkaktuar nga rryma alternative per linjat e tubacioneve prej s;eliku me mbrojtje katodike dhe masat mbrojtese.

GW 120 (A), Dokumentacioni i rrjetit ne shoqerite e furnizimit. GW

125 (H), Pemet, linjat nentokesore dhe kanalet.

GW 301 (A), Kriteret e kualifikimit per shoqerite e ndertimit te linjave te tubacioneve.

GW 304 (A), Avancimi i tubave (pipe jacking) dhe metodat e ngjashme (pros;eset e lidhura mete)

GW 315 (H), Udhezime per masat mbrojtese te impianteve te furnizimit gjate punimeve te ndertimit.

GW 321 (A), Metoda horizontale e shpimit me shpelarje per linjat e tubacioneve te gazit dhe uji; Kerkesat teknike, sigurimi i cilesise dhe testimi.

GW 340 (A), (Veshje me lias;. s;imento dhe fibra plastike ose xhami)- veshja per mbrojtjen mekanike te tubave dhe rakorderive prej s;eliku me mbeshtjellje Poliolefin.

GW 350 (A), Lidhjet me saldim ne linjat e tubacioneve prej s;eliku ne furnizimin me gaz dhe me uje-prodhimi, testimi dhe vleresimi.

10.2 Standardet DIN

DIN 2425-1, Plani per ekonomine e furnizimit, ekonomine e ujit dhe furnizimet ne distanca te largeta - Planet e rrjetit te tubacioneve te sistemeve publike te furnizimit me gaz dhe me uje.

DIN 2425-3, Plani per sherbimet publike, menaxhimin e ujit dhe per furnizimet ne distanca te largeta - Planet per rrjetet e tubacioneve.

DIN 4065, Tubacionet e gazit, tabelat sinjalizuese.

DIN 4069, Tubacionet lokale te shperndarjes se gazit; tabelat sinjalizuese.

DIN 4124, Gropat e ndertimit dhe kanalet; rrepirat, punimet ndertuese, gjeresia e hapesires se punes.

DIN 30670, Mbeshtjellja e tubave dhe rakorderive te s;elikut me polietilen.

DIN 30672, Mbeshtjellja organike per mbrojtjen nga korrozioni per linjat e tubacioneve te shtrira nen toke dhe te zhytura ne uje per temperaturat e vazhdueshme te operimit deri 50 •C pa mbrojtje katodike nga korrozioni -fashot dhe materialet tkurrese.

DIN 30675-1, Mbrojtja e jashtme nga korrozioni e linjave te tubacioneve te shtrira nen toke, masat mbrojtese dhe aplikimi i tyre ne linjat e tubacioneve prej s;eliku.

DIN 30677-2, Mbrojtja e jashtme nga korrozioni e valvolave te instaluara nen toke, mbeshtjellja me duroplast (shtresa e jashtme) per kerkesat e percaktuara teknike.

DIN 30678, Mbeshtjellja e tubave te crelikut dhe rakorderive me polipropilen.

10.3 Buletine

Buletini teknik VdTUV Tubot 1054, Direktiva per prodhimin dhe testimin e tubave te harkuar ne gjendje te ftohte per linjat e largeta; Linjat e tubacioneve ne distance.

Buletin teknik VdTOV Tubot 1063, Direktiva teknike per perllogaritjen statike te tubove te crelikut te instaluar nen toke; Linjat e tubacioneve ne distance.

MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE

Rregullat Teknike per Industrine e Gazit

Kodi i praktikave G 472, Korrik 2012

Autorizuar nga DVGW

Linjat e gazit me tubacione polietileni per presion operimi deri ne 10 bar - Ndertimi

Pershtatur nga Ministria Energjise dhe Industrise (MEI) Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit te Hidrokarbureve
www.energjia.gov.al

TIRANE 2016

Parathenie

Rregullat Teknike per Industrine Shqiptare te Gazit jane pergatitur nga Min istria e Energjise dhe Industrise (MEI), ne zbatim te kerkesave te ligjit nr. 102/2015, date 23.09.2015, "Per sektorin e gazit natyror", si pershtatje e Rregullave Teknike per Industrine e Gazit te Shoqates Shkencore e Teknike Gjermane per Gazin e Ujin (DVGW). Pershtatja e ketyre Rregullave Teknike per Industrine Shqiptare te Gazit eshte realizuar nga Grupi i Eksperteve te MEI per Rregullat Teknike te Gazit, prane Drejtorise se Politikave dhe Zhvillimit te Hidrokarbureve, ne bashkepunim me DVGW ne kuader te projektit "Perkthimi dhe pershtatja e Rregullave Teknike per Sektorin Shqiptar te gazit" i cili eshte financuar nga nje fond dhene nga Qeveria Zviceriane ne kuader te Marreveshjes per ngritjen e kapaciteteve ne sektorin e gazit ratifikuar me ligjin nr. 58/2015, date 28.5.2015, "Per ratifikimin e marreveshjes ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Konfederates Zvicerane per Grantin e Asistences Financiare per projektin "Ngritja e kapaciteteve per zhvillimet ne permasa te medha te infrastruktures se gazit ne Shqiperi, II".

Pergatitja e tyre eshte perballur me sfiden e pershtatjes se referencave te dokumentacionit origjinal ne legjislacionin Gjerman ne fuqi me legjislacionin perkates ne Shqiperi. Ne rrethanat kur legjislacioni perkates ne Shqiperi ende nuk eshte plotesuar, permendja e parimeve baze ka zevendesuar pamundesine e referencave specifike ne legjislacionin shqiptar.

Ky rregull teknik eshte bazuar ne dokumentin origjinal te kuadrit rregullator te rregullave teknike te DVGW-G 472, *"Gas/eitungen aus Po/yethylenrohren bis 10 bar Betriebsdruck-Errichtung"*botimi ikorrik 2012.

Pershtatja dhe perpunimi i tij eshte kryer nga Grupi i Eksperteve te ME I per Rregullat Teknike te Gazit, ne bashkepunim me eksperte te DVGW:

Dr. Jochen Adam	- ekspert i DVGW
Ing. Besnik Bozgo	- koordinator iGrupit Shqiptar te Eksperteve
Ing. Ilir Metaj	-specialist
Ing. Arben Tare	- specialist
Ing. Arbi Murataj	- specialist
Z. Florenc Qosja	- perkthyes iautorizuar i DVGW

Proc;:edura e aplikuar ne kete projekt eshte si me poshte:

Permbajtja teknike e ketij dokumenti nuk eshte ndryshuar ne raport me dokumentin baze (burimor)

Ndryshime qe nuk ndryshojne permbajtjen teknike, por qe jane te qenesishme per zbatimin e ketij dokumenti.

Rregullat teknike te DVGW ne tekstin e kesaj rregulloreje teknike kane te bejne vetem me germen "G" (gaz) ose "GW" (gaz dhe uje) si dhe numrin perkates.

Standardet ISO dhe EN jane standardet nderkombetare dhe europiane te adoptuara si standarde shqiptare nga Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit ne Shqiperi. (DPS)

Ne dokument jane vene shenime ne fund te faqes per spjegimet e nevojshme lidhur me aktet nenligjore burimore apo ndryshime te paraqitjes se organeve 9ertifikuese ne raport me tekstin baze (burimor). Ne pro9eduren e harmonizimit te ketij dokumenti, ligjet e cituara ne tekstin baze (burimor) jane zevendesuar me ligjet respektive shqiptare.(kur ato egzistojne)

Me qellim te harmonizimit me te rejat me te fundit te industrise e teknikes ky Rregull Teknik do te perditesohet rregullisht bazuar ne ndryshimet dhe plotesimet aktuale te kryera ne standardet europiane dhe shqiptare.

Ne pergatitjen e ketij rregulli teknik eshte marre autorizimi nga DVGW-ja dhe ai eshte miratuar ne takimin e Keshillit koordinues te projektit "Perkthimi dhe Pershtatja e Rregullave Teknike per Sektorin Shqiptar te Gazit" date:.....

Koordinatore e Projektit nga DVGW

Dipl.- GDFS Znj. Hiltrud Schuelken

Koordinator i Projektit nga MEI

Prof. As. Dr. Stavri Dhima

Tirane, .09.08.2016.

Hyrje

Kerkesat teknike per impiantet dhe linjat e tubacioneve te furnizimit te publikut me gaz jane pershtatur me ndihmen e standardeve funksionale te Komitetit Teknik CEN/TC 234 "Infrastruktura e gazit". CEN/TC 234 eshte Komiteti Teknik Europian i Standardizimit, i cili ka per detyre hartimin e kerkesave teknike baze dhe te unifikuara ne te gjithe Europen per sistemin e furnizimit me gaz.

Aktivitetet standardizuese europiane ne CEN/TC 234 perbejne aresyen e perpunimit te ketij kuadri rregullator te furnizimit me gaz, lidhur me kerkesat teknike te standardeve europiane. Qellimi eshte qe ky kuader te jete jo vetem pa kontradikta nga pikepamja teknike por dhe i pershtatur formalisht me kushtet e ndryshuara, ne menyre qe perdorimi i tij te permbushe njekohesisht edhe kerkesat teknike te standardeve europiane per shperndarjen e gazit.

Bazen per kete perpunim e perbejne standardet SSH EN 12007-1, SSH EN 12007-2 dhe SSH EN 12327.

Meqenese mbas rishikimit te trete te ketij kodi, presioni maksimal i operimit eshte ngritur ne 10 bar, jane perfshire edhe nivelet e presionit 2 bar dhe 5 bar nga standardet europiane.

SSH EN 12007-1 dhe SSH EN 12186 lejojne hapesira mete medha per konfigurimin e presionit te sistemeve te shperndarjes. Ne rast se jane shfrytezuar pertej kufirit maksimal te lejuar deri tani (presioni maksimal i lejuar i operimit me nje tejkalim deri ne maksimalisht 10% ne rast avarie), duket te mbahet parasysh pershtatshmeria e te gjitha pjeseve perberese te perdoruara, ne sistemet e linjave te tubacioneve.

Per tubat polietileni te perforcuar me fibra (xhami, aramid, karboni) (RTP-Reinforced Thermoplastic Pipe, smart pipe), per presionet mbi 10 bar ekziston nje baze e testimit sipas standardit. Ne njeren nga shtojcat eshte skicuar, se si duhet vepruar, ne rastet kur synohet perdorimi itubove plastike jashte zones se parashikuar fillimisht per perdorimin e ketij kodi te praktikave.

Eshte marre parasysh dhe nje pershtatje sa me e zgjeruar me kodin e praktikave G 462 "Linjat e gazit me tuba <;:eliku me nje presion operimi deri ne 16 bar- Ndertimi". Ketu bejne pjese rishikimi i distancave minimale si dhe kerkesat ne perputhje me 3.1, sipas <;:ertifikates se testimit te pranimit per komponentet, per sa kohe qe ato duhet te perdoren per presionet e operimit mbi 5 bar.

Momentalisht per diapazonin e presionit mbi 5 bar nuk ekziston nje kod i praktikave per mirembajtjen e linjave te tubacioneve te gazit prej polietileni. Deri ne publikimin e nje kodi te praktikave duhet te perdoret ne menyre te pershtatur kodi i praktikave G 466-1 "Linjat e gazit me tuba <;:eliku per nje presion operimi mbi 5 bar- Mirembajtja".

1. Fusha e perdorimit

Ky kod i praktikave vlen per projektimin, ndertimin, testimin dhe venien ne pune te linjave te tubacioneve prej polietileni, qe sherbejne per furnizimin e publikut me gaz, per nje presion[1] maksimal te lejueshem sipas tabeles 1, ne te cilet transmetohet gaz ne perputhje me kodin e praktikave G 260 -duke perjashtuar gazin e lengshem ne gjendjen e tij te lengshme.

Tabela 1 -Presionet maksimale te lejueshem te operimit per linjat e tubacioneve prej polietileni[2]

Seria e SDR*	Diametri	PESO	PE 100	PE-X**
SDR 17,6	75 mmsdns 630 mm	2 bar	5 bar	-
SDR17	75 mmsdns 630 mm	-	5 bar	-
SDR 11	dns 630 mm	5 bar	10 bar	-
SDR 11	dns 250 mm	-	-	8 bar

SDR eshte raporti midis diametrit dhe spesorit se murit te tubit (Standard-Dimension-Ratio), d.m.th. raporti i diametrit te jashtem nominal dn me trashesine nominale te murit s. Per dn< 75 mm mund te perdoret vetem SDR 11.
PE-X permbledh materialet PE-Xa, PE-Xb dhe PE-Xc

Versioni i ri i ketij kodi te praktikave ka marre parasysh kerkesat teknike te standardeve SSH EN 12007-1, SSH EN 12007-2 dhe te standardit SSH EN 12327.

Ky kod i praktikave mund te perdoret ne menyre analogjike edhe per linjat e tubacioneve te gazit prej materialeve te tjera plastike ose per presionet operuese maksimale te lejueshme deri ne 16 bar. Kjo gje kerkon nje mbeshtetje te ve9ante inxhinierike ne perputhje me shtojcen A.

Per linjat e tubacioneve, qe nuk sherbejne per furnizimin e publikut me gaz, ose per gazet qe nuk jane ne perputhje me kodin e praktikave G 260, ky rregull teknik mund te perdoret ne menyre analogjike duke marre parasysh vetite e gazeve dhe ne rast nevoje dhe te rregullave te tjera ne fuqi.

---

1 Te gjitha presionet ne kete kod te praktikave jane mbi presione mbi presionin atmosferik perkates egzistues.

2 Presionet operuese maksimale te lejueshme jane ne perputhje me standardet SSH EN 12007-1 dhe 2. Presioni operues maksimal i lejueshem nga operatori i rrjetit eshte percaktues per perdorimin e ketij kodi te praktikave, nder te tjera per zgjedhjen e komponenteve dhe testimin e presionit. Per linjat ekzistuese te tubacioneve te gazit vlejne edhe ne te ardhmen presionet operuese maksimale te lejueshme te percaktuara ne momentin e ndertimit te saj, pikerisht 1 bar ose 4 bar ne perputhje me versionin e meparshem te ketij kodi te praktikave. Ne rast te ngritjes se mevonshme te presionit ne linjat ekzistuese te tubacioneve, operatori i rrjetit duhet te deshmoje pershtatshmerine e komponenteve te perdoruar deri tani duke respektuar kodin e praktikave G 457 (A).

Versioni i ri i kEHij kodi te praktikave ka marre parasysh kerkesat teknike te standardeve SSH EN 12007-1, SSH EN 12007-2 dhe te SSH EN 12327.

Ne rastet kur shoqerite, gjate ndertimit te impianteve te reja perdorin opsionet e pershkallezimit te presionit te pershkruara ne standardin SSH EN 12007-1, duhet te mbahet parasysh, qe komponentet e perdorur duhet te jene te projektuar per presionet e kerkuara te testimit.

2. Standardet referuese

Dokumentet e cituara me poshte jane te domosdoshme per perdorimin e ketij Kodi. Per referencat me date, vlen dhe zbatohet vetem botimi icituar ndersa per referencat pa date, vlen dhe zbatohet botimi me i fundit i dokumentit referues.

SSH EN 331:1998/A1:2010, Valvolat me sfere dhe me mashkull konik me fund te mbyllur, me komandim me dore, per impiantet e gazit ne ndertesa.

SSH EN 10204, Produktet metalike -llojet dhe 9ertifikatat e testimit

SSH EN 12007-1, Sistemet e furnizimit me gaz- Linjat e tubacioneve me nje presion maksimal operimi te lejueshem deri ne e perfshi 16 bar- Pjesa 1: Kerkesat teknike te pergjithshme funksionale.

SSH EN 12007-3, Sistemet e furnizimit me gaz- Linjat e tubacioneve me nje presion maksimal operimi te lejueshem deri ne e perfshi 16 bar- Pjesa 2 : Kerkesat teknike funksionale te ve9anta per polietilenin (MOP deri ne e perfshi 10 bar)

SSH EN 12327, Infrastruktura e gazit- Testimi nen presion, Komisionimi dhe dekomisionimi- Kerkesat teknike funksionale.

SSH EN 12186, Sistemet e furnizimit me gaz -Impiantet e rregullimit te presionit te gazit per transmetim dhe shperndarje- Kerkesat teknike funksionale.

SSH EN 13774, Valvolat, ventilat per sistemet e shperndarjes se gazit me presionet operuese te lejueshme mete vegjel ose te barabarte me 16 bar -Kerkesat teknike per gjendjen e perdorimit.

OS CEN/TS 15223, Sistemet e linjave te tubacioneve plastike -Parametrat perllogarites ne fuqi te sistemeve te linjave te tubacioneve termoplastike, te instaluar nen toke.

SSH EN ISO 3183, Industria e naftes dhe gazit natyror- Tubacionet prej 9eliku per sistemet e transmetimit me linja tubacionesh.

3. Te pergjithshme

3.1 Parimet baze

Projektimi, ndertimi, testimi dhe venia ne pune kryhen nga shoqeria. Ne kuptimin e ketij rregulli teknik shoqerite jane: personat juridike pergjegjes ose shoqerite, qe ne kuadrin e drejtimit te pergjithshem te shoqerise jane pergjegjes ne origjine, ose si nenkontraktues per projektimin, ndertimin, testimin dhe venien ne pune te impianteve energjetike -ose te tjere te nenkontraktuar prej tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe rregullat e njohura te teknikes. Per sa kohe qe shoqerite nenkontraktojne pale te treta me keto detyra, keto te fundit jane te detyruara te respektojne legjislacionin ne fuqi dhe rregullat e teknikes.

3.2 Personeli dhe mbikeqyrja e punimeve

Shoqeria duhet te kujdeset per nje mbikqyrje profesionale te punimeve, ne perputhje me llojin dhe kompleksitetin e projektit te ndertimit. Ne kete rast behet fjale per personal te kualifikuar nga ana profesionale te shoqerise, ose per te tjere te nenkontraktuar.

Ndertimi i linjes duhet te kryhet nga shoqerite ose nje shoqeri e ndertimit te linjave te tubacioneve. Shoqeria e ndertimit te linjave te tubacioneve e nenkontraktuar duhet te zoteroje dhe te kete paraqitur deshmite e nevojshme. Deshmite quhen te plotesuara, nese paraqitet nje c;:ertifikim ne perputhje me standardet europiane dhe me kodet e praktikave GW 301 ose GW 302. Shoqeria qe kryhen vete ndertimin e linjes, duhet te plotesoje kerkesat teknike te standardeve europiane dhe kodeve te praktikave GW 301 ose GW302.

Te gjitha punet sipas ketij kodi te praktikave duhet te kryhen nga persona te kualifikuar nga ana profesionale. Saldatoret e tubacioneve prej polietileni (PE) duhet te trajnohen dhe te testohen ne perputhje me standardin europian dhe kodin e praktikave GW 330.

Punimet e saldimit PE duhet te drejtohen dhe te testohen nga nje mbikeqyres sipas udhezimit GW 331 dhe standardit europian.

3.3 Personate kualifikuar, specialisti teknik, eksperti teknik

Ne kuadrin e ketij kodi te praktikave mund te veprojne vetem personat e poshteshenuar te kualifikuar nga ana profesionale:

- Personat e kualifikuar te shoqerise se ndertimit te linjave te tubacioneve, d.m.th. personat qe ne baze te formimit te tyre profesional, aktivitetit dhe pervojes teknike kane njohuri te mjaftueshme ne fushen ne te cilen u ngarkohen detyra. Ata jane te familjarizuar me rregullat teknike, ne menyre qe te garantojne kryerjen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te detyrave te ngarkuara.

- Specialistet teknike te shoqerise se ndertimit te linjave te tubacioneve, d.m.th. personat, qe ne baze te formimit dhe pervojes se tyre zoterojne njohuri profesionale te mjaftueshme, jane te familjarizuar me rregullat ligjore ne fuqi si dhe rregullat teknike (si kodet e praktikave, standardet SSH, EN, ISO, direktivat europiane etj.), sa qe

mund te gjykojne mbi gjendjen e sigurt te operimit te linjave te tubacioneve. Kualifikimi i tyre duhet te garantohet nepermjet trajnimeve te rregullta dhe te dokumentohet ne menyren e duhur. Ata duhet te emerohen me shkrim nga shoqeria.

• Ekspertet teknike jane:

- Ekspertet, qe iperkasin nje qendre inspektimi te njohur per testimet e linjave te gazit ose
- Ekspertet, qe jane <;ertifikuar nga nje qender <;ertifikimi si ekspert teknik per testimet sipas ketij kodi te praktikave.

Per ekspertet teknike vlejne kerkesat e kualifikimit te pershkruara ne kodin e praktikave G 100.

4. Projektimi

4.1 Pergatitja e trasese

Gjate pergatitjes se trasese duhet te merren parasysh kushtet specifike ne terren dhe shfrytezimet e mundshme te trasese qe mund te parashikohen per te ardhmen. Nuk lejohet ndertimi i objekteve mbi linjat e tubacioneve te gazit, ose i <;do lloj ndertimi tjeter mbi te, si dhe depozitimi imaterialeve te veshtira per tu transportuar, si dhe mbjellja e pemeve, te cilat pengojne aksesin ne linjat e tubacioneve. Ne zonen e mbjelljes se pemeve duhet te merret parasysh udhezimi GW 125.

Per te siguruar qendrueshmerine e linjave te tubacioneve per presionet maksimale operuese te lejueshme mbi 5 bar si dhe operimin e mirembajtjen e tyre kundrejt nderhyrjeve nga jashte duhet qe ato te shtrihen ne nje zone te mbrojtur. Ne zonen e mbrojtur, gjate kohes se ekzistences se linjes se tubacioneve, nuk lejohet te ndertohen objekte ose te menjanohen nderhyrjet e tjera, qe pengojne ose rrezikojne qendrueshmerine, operimin dhe mirembajtjen e tyre. Ndertimi p.sh. i shesheve te parkimit mbi linjen e tubacioneve eshte i lejueshem vetem me miratimin e shoqerise. Gjeresia e brezit mbrojtes percaktohet nga shoqeria ne perputhje me diametrin e linjes se tubacioneve si dhe me llojin e masave operuese dhe te mirembajtjes.

Identifikimi formal i nje zone/brezi te mbrojtjes ne rastet e siperfaqeve te transportit publik (p.sh. rruget dhe kalimet e kembesoreve) mund te zevendesohet nga nje leje zyrtare per shtrirjen e linjave te tubacioneve. Rregulli kontraktual duhet te parashikoje percaktimet per identifikimin e zones/brezit te zakonshem mbrojtes ne rastin e shfrytezimit te siperfaqes se transportit publik.

Linjat e gazit mund te shtrihen edhe ne hapesirat boshe si p.sh. kanale ose ura, ne rast se keto hapesira jane mjaftueshmerisht te ajrosura apo te mbushura, ose nese mund te perdoren tubacione me mbeshtjellje, qe perfundojne pertej ketyre hapesirave.

Linjat e tubacioneve te lira, te aksesueshme, p.sh. ne pasazhe duhet ne rast nevoje te jene te mbrojtura nga nderhyrjet nga jashte. Per linjat e lira, p.sh. nen ose poshte nje ure ose kanali, duhet te mbahet parasysh kodi i praktikave G 414 dhe G 614.

Ne zonat ku mendohet se mund te kete levizje te tokes, e cila mund te rrezikoje sigurine e linjes se tubacioneve te gazit, p.sh. ne zonat e ndikimit te minierave, ne raste te ve<;:anta duhet te merren masat e nevojshme te sigurise, p.sh. ne perputhje me kodin e praktikes G 474.

4.2 Distancat minimale

4.2.1 Te pergjithshme

Ne rastet kur linja e furnizimit shtrihet paralelisht me nje linje tjeter te furnizimit ose te pajisjeve te tjera te furnizimit, ose ne rastet kur ato kryqezohen, duhet te respektohet nje hapesire minimale drite per operimin dhe mirembajtjen, si dhe per te menjanuar demtimet. Ne rast se keto distanca minimale nuk mund te respektohen, duhet te merren masat e duhura per mbrojtjen e pajisjeve te furnizimit.

Gjate projektimit dhe zgjedhjes se materialeve duhet te merret parasysh afersia e sistemeve me <;:lirim nxehtesie (p.sh. linjat e kaldajave/ngrohjeve ne distance ose e kabllove te energjise).

4.2.2 Distancat minimale te linjave te gazit nga linjat e furnizimit/te shkarkimit ose nga ndertesat

Distancat minimale te linjave te gazit ne ndertimet e hapura nga linjat e tjera te tubacioneve dhe ndertimeve te ndryshme nuk duhet te tejkaloje:

- gjate kalimeve paralele, gjysmen e diametrit te jashtem te linjes se tubacionit mete madh, porte pakten duhet 0,2 m;

- 0,1 m gjate kryqezimeve

Gjate ndertimeve te linjave pa kanale duhet te merren parasysh perve<;: ketyre distancave edhe tolerancat e kushtezuara nga terreni dhe pro<;:edurat e operimit.

4.2.3 Distancat minimale nga kabllot

Distancat minimale te linjave te gazit nga kabllot e energjise ne germimet e hapura, pa masa te ve<;:anta mbrojtese, nuk duhet te jete me pak se vlerat e meposhtme:

- Per presionin operues maksimal te lejueshem deri ne e perfshi 5 bar:
  ne kalimet paralele 0,2 m dhe ne kryqezimet 0,1 m;

- Per presionin operues maksimal te lejueshem mete madh se 5 bar:
  ne kalimet paralele 0.4 m dhe ne kryqezimet 0,2 m.

Rritja e distancave ne diapazonin e presionit maksimal operues te lejueshem me te madh se 5 bar nuk i sherben mbrojtjes nga ndikimet ne operimin normal. Ne kete rast jane te mjaftueshme distancat si ne presionin operues maksimal te lejueshem deri nee perfshi 5 bar. Ato i sherbejne venies ne dispozicion te nje hapesire te mjaftueshme pune per punimet e nevojshme ne linjat e tubacioneve.

Ne rastet kur distancat per mbrojtjen nga ndikimet ne openmm normal nuk mund te respektohen, duhet qe per mbrojtjen e linjave te gazit te parashikohen masat e nevojshme, p.sh. vendosja e shtresave ose e pllakave qe rregullojne shkembimin e nxehtesise. Keto masa ne rast nevoje duhet te koordinohen me operuesit e kabllove.

Gjate ndertimeve pa kanale duhet te merren parasysh perve9 ketyre dista ncave edhe tolerancat e kushtezuara nga terreni dhe proyedurat e operimit.

4.2.4 Distancat nga impiantet e energjise se eres

Distancat nga impiantet e energjise se eres duhet te vendosen ne lidhje me mundesine e nje rreziku te mundshem mekanik te linjes.

4.3 Tubat dhe komponentet e linjave te tubacioneve

Te gjitha komponentet duhet te projektohen per presionin operues maksimal te lejueshem. Ato duhet te deshmojne nje vule 9ertifikimi nga autoriteti 9ertifikues si me poshte:

- Tubat prej PE 80 ose PE 100: Qertifikim CE, ISO, EN, ose GW 335-A2
- Tubat prej PE-Xa: Qertifikim CE, ISO, EN, ose GW 335-A3
- Rakorderite prej PE 80 ose PE 100: <;ertifikim CE, ISO, EN, ose GW 335-B2(A)
- Valvola shpuese per linjen nen presion ne perputhje me standardin perkates.
- Pajisjet bllokuese prej PE 80 ose PE 100. Valvolat e mbylljes se gazit prej polietileni ne perputhje me standardin.
- Pajisjet bllokuese prej materialeve metalike: SSH EN 331 ose SSH EN 13774
- Bashkimet 9elik-PE ne perputhje me standardin perkates.

Per valvolat shpuese nen presion qe do te saldohen duhet qe prodhuesi te deshmoje saldueshmerine nen presionin operues maksimal te lejueshem.

Per presionet operuese maksimale te lejueshme mbi 5 bar duhet te 9ertifikohen komponentet nepermjet nje deshmie te testimit te pranimit 3.1 sipas standardit SSH EN 10204 (shiko shtojcen B). Klasifikimi i komponenteve dhe deshmise se testimit te pranimit duhet te sigurohet nepermjet nje shenjimi/marktimi te dallueshem.

Komponentet e perbere nga materiale te ndryshme nga polietileni (PE) duhet te deshmojne nje lidhje te pershtatshme ne perputhje me standardin perkates dhe te jene te markuara. Materialet prej metali duhet te mbrohen nga korrozioni. Vendosja e mbrojtjes nga korrozioni nuk duhet te kete nje ndikim negativ tek polietileni.

4.4 Valvolat bllokuese dhe pajisjet shfryrese

Montimi i valvolave bllokuese kryhet ne perputhje me kerkesat e furnizimit dhe te kushteve ne vend. Per linjat e tubacioneve te gazit me presion operimi me te madh se 100 mbar duhet te parashikohen pajisje, te cilat sherbejne per te nxjerre nga operimi zona te caktuara te rrjetit te tubacioneve ose per te ulur presionin e operimit.

Per linjat e gazit me presion operues maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar duhet te parashikohen pajisje shkarkuese ne vende te aksesueshme.

4.5 Sigurimi i presionit

Presioni maksimal operues i lejueshem i linjave te tubacionit te gazit nuk duhet te tejkalohet. Per sigurimin e presionit, vec;:anerisht ne lidhje me tejkalimet e presionit operues maksimal te lejueshem duhet te mbahet parasysh kodi i praktikave G 491.

4.6 Ndertimet pa kanale, germimet pa hapesire pune te kalueshme

Per ndertimet e kanaleve pa hapesira pune te kalueshme (per rehabilitim, rinovim, nderrim tubosh apo instalimet e reja) duhet te sigurohet, qe te mbahen parasysh kerkesat teknike te ketij kodi te praktikave, vec;:anerisht ne lidhje me distancat minimale dhe shtresat mbuluese minimale. Ne rastet e ndertimeve pa kanale duhet te merren parasysh kodet e praktikave GW 304, GW 320-1, GW 320-2, GW 321, GW 322-1, GW 322-2, GW 324 dhe GW 325 si dhe udhezimi GW 323.

4.7 Dokumentet e ndertimit

Per zbatimin e punimeve, ne rast se eshte e nevojshme, duhet te hartohen planet e vendosjes dhe te punimeve.

5. Ekzekutimi i punimeve

5.1 Brezi i punes

Perpara fillimit te punimeve duhet te percaktohet nje brez, i cili sherben si zona e punes per ndertimin e linjes se tubacioneve te gazit. Brezi i punes duhet te jete ne perputhje vec;:anerisht me diametrin e linjes, llojin dhe sasine e germimeve dhe makinerite qe do te perdoren. Linjat e furnizimit qe ndodhen ne brezin e punes nuk duhet te rrezikohen. Per kete duhet te tregohet kujdes duke respektuar udhezimin GW 315 (Guidelines for measures to protect facilities for the supply during construction works) vec;:anerisht ne kryqezime dhe ne kalimet paralele dhe ne rast nevoje te merren masat e nevojshme (p.sh. c;:arje terthore, puset/germimet e hapura me dore/krahe).

5.2 Transportimi itubove dhe magazinimi i tubove

Ne menyre qe te mbrojme tubacionet nga demtimet, duhet qe ngarkimi dhe shkarkimi i tyre te behet me pajisje te ve9anta dhe gjate transportit, ne rast se eshte e nevojshme, te ndahen me shtresa te ndermjetme dhe te sigurohen kundrejt ndikimeve demtuese, si p.sh. zhvendosjet, varjet dhe lekundjet.

Magazinimet dhe lartesite e stivave duhet te zgjidhen ne menyre te tille, qe te menjanohen demtimet e tubave. Stivat e tubave duhet te sigurohen nga rrokullisjet e mundshme.

Komponentet prej PE duhet te magazinohen ne perputhje me te dhenat e prodhuesit dhe te mbrohen nga lendet demtuese te PE. Ne rastet e magazinimeve per me shume se dy vjet, per sa kohe qe nuk eshte dhene nga prodhuesi nje periudhe kohore me e shkurter, duhet qe te mbrohen nga rrezet direkte te diellit.

Perpara perdorimit te komponenteve te magazinuara per me shume se dy vjet ne ambient te hapur duhet te merret nje deklarate sigurie nga prodhuesi ose te sigurohet nje deshmi e pershtatshmerise se perdorimit.

Skajet e tubave duhet te mbahen te mbyllur deri ne pergatitjen dhe ne prodhimin e bashkimeve.

Per tubat PE-X duhet te mbahen parasysh ne menyre te ve9ante kohezgjatja e magazinimit te hapur.

5.3 Mbulesat minimale (shtresat mbuluese minimale)

Lartesia e mbulimit te tubacioneve duhet te pershtatet sipas kushteve ne terren. Linja e tubacionit te gazit si rregull per nje presion operimi maksimal te lejueshem deri ne 5 bar duhet te mbulohet me nje trashesi 0,6 deri ne 1 m, per nje presion operimi maksimal te lejueshem mbi 5 bar nga 0,8 deri ne 1 m. Mbulimi ne vendet e kufizuara pa masa te veyanta mbrojtese mund te zvogelohet deri ne 0,5 m per nje presion operimi maksimal te lejueshem deri ne 5 bar ose deri ne 0,6 m per nje presion operimi maksimal te lejueshem mbi 5 bar, per sa kohe qe nga kjo nuk pritet ndonje ndikimi i palejueshem tek linjat e tubacioneve te gazit. Kjo shtrese nuk duhet ti tejkaloje 2,0 m pa ndonje arsye te ve9ante. Per devijimet qe dalin jashte ketyre percaktimeve duhet te merren ne rast nevoje masat e duhura (p.sh. tub mbrojtes, pllaka betoni, rillogaritje e statikes se tubit, mure me te trasha te tubave).

5.4 Kontrolli i komponenteve

Komponentet duhet te kontrollohen para montimit te tyre qe te jene ne gjendje te mire dhe te kene markimet/shenjimet e plota, ne perputhje me rregullat e permendura ne 4.3. tek tubat PE (pa shtresa aditive), gervishtjet dhe zhveshjet siperfaqesore jane te lejueshme deri ne 10% te trashesise nominale te murit. Tubacionet me demtime mete medha nuk lejohet te montohen.

5.5 Kanalet e tubacioneve dhe germimet/pusetat e nevojshme (vendet e valvolave)

Kanalet e linjave te tubacioneve dhe germimet duhet te kryhen mbi bazen e diametrit te jashtem te tubit dhe te permasave te komponenteve te tjere ne perputhje me standardin perkates (DIN 4124, Excavations and trenches) Bazamenti i kanalit duhet te behet i tille, ne menyre qe linja e gazit te shtrihet plotesisht.

Ne rastet e terreneve qe nuk kane aftesi mbajtese ose me permbajtje te larte uji, linja e tubacioneve te gazit, ne rast nevoje duhet te sigurohet nga forcat kundervepruese.

Ne segmentet e pjerreta te trasese se linjes duhet te merren masa kundrejt efekteve te drenazhimit te kanalit te tubave. Ne shpatet e maleve duhet te merren masat e duhura per te penguar rreshqitjet e tokes dhe te linjes se tubacioneve.

5.6 Montimi dhe bashkimi/lidhjet

5.6.1 Te pergjithshme

Tubat duhet te lidhen mundesisht pa tendosje. Per kete mund te perdoren:

- Saldimi koke me koke me ngrohje(HS) (butt fusion) ose
- Saldim me elektrofuzion (HM) (Eiektrofusion) sipas Tabeles 2 ose
- Bashkues mekanike.

Ne rastin e saldimit koke me koke me ngrohje duhet qe vlerat SDR (standard dimension ratio) te perputhen me vlerat e MFR (melt flow rate indeks).

Ndryshe nga kerkesat teknike te paraqitura ne 5.4. ne zonen e saldimit ose ne zonen e dendur te bashkimeve mekanike nuk duhet te ekzistojne me goditje dhe gervishje, mbas kryerjes se pastrimit (qerimit).

Tabela 2 -Pro edurat e saldimit

Tubacionet		Pjese te ndryshme te tubacioneve"."				
Lloji i tubacionit	Presioni operues maksimal i lejueshem (bar)	PE80		PE 100		PE-X
		SDR 11	SDR17 SDR 17,6	SDR 11	SDR17	SDR 11
Linja tubacionesh ekzistuese prej PE-HD, PN 6, Radha e tubove 4°	1	HM	HM/HS	HM	HM/HS	HM
Linja tubacionesh ekzistuese prej PE-HD, PN 10, Rohrreihe 5 c	4	HM/HS	-	HM/HS	HM	HM
PE 80- SDR 17 dhe SDR 17,6	2	HM	HM/HS	HM	HM/HS	HM
PE 80 -SDR 11	5	HM/HS	-	HM/HS	HM	HM
PE-X- SDR 11	8	-	-	HM	-	HM
PE 100 - SDR 17 dhe 17,6	5	HM	-	HM	HM/HS	HM
PE 100 - SDR 11	10	-	-	HM/HS	-	HM

a Kombinimet vlejne edhe per presionin operues maksimal te lejueshem te linjes se tubacioneve ne perputhje me kolonen 2. Ne rastet e presioneve operuese te uleta mund te behen dhe kombinime te tjera.
b vlen edhe per Tub/Tub ne rastin e HS.
c emertimi sipas standardit perkates (Polyethylene (PE)-Pipes PE 80, PE 1GO-Dimensions) (p.sh. HDPE, PEe forte, PE Tipi II). SSH ISO 4437-Sistemet e tubave plastike per furnizimin e lendeve djegese te gazta-PE

HS- Saldimi koke me koke me ngrohje; HM -Saldim me elektrofuzion

Per diametrin *dn* s; 63 mm ne kantier rekomandohet si proc;:edure saldimi, saldimi me elektrofuzion (HM).

Bashkime te tjera jane te lejueshme, per sa kohe qe sigurohet ne menyre te qendrueshme hermeticiteti i gazit, rezistenca ndaj presionit, dhe ne rast se kerkohet edhe qendrueshmeria ne terheqja. Lidhjet me fasheta kerkojne nje trup mbeshtetes.

Komponentet duhet te trajtohen me kujdes per menjanimin e demtimeve (p.sh. nepermjet thyerjes dhe gervishtjes). Gjate instalimit te tubave dhe te rakorderive duhet te mbahen parasysh udhezimet e prodhuesve. Kjo vlen vec;:anerisht gjate perpunimit per diapazonet e temperaturave nen 5°C. Ketu duhet te krijohen kushte te tilla, qe lejojne nje perpunim te sigurte dhe pa defekte, dhe ne rast nevoje duhet qe te ngrohen materialet lidheze unazore, skajet e tubove dhe rakorderite. Tubat duhet qe te priten pingul me aksin, pjeset fundore/skajet duhet te pergatiten ne perputhje me proc;:eduren e bashkimit.

Ne rast te nderprerjes se punimeve duhet qe skajet fundore te mbyllen ne menyre te tille, qe te mos lejojne depertimin ne tote ujit apo te lendeve te tjera te jashtme.

Duhet te mbahen parasysh ndryshimet e gjatesive te tubave gjate ndryshimit te temperatures (afersisht 0,2 mm/m*K).

Gjate shtypjes/demtimit te tubove PE duhet te mbahet parasysh kodi i praktikave GW 332. (Shtypja e tubacioneve prej polietileni ne shperndarjen e gazit dhe ujit)

Ne rastet e rrezikut te permbytjeve duhet qe linja te sigurohet deri ne mbulimin e plote te saj per te shmangur forcat kundervepruese.

Ne rast se kemi te bejme me nje presion operues maksimal te lejueshem me te madh se 5 bar, ne kuadrin e ecurise se punimeve duhet te mbahet nje regjister itubacioneve (shiko Shtojca C) per punimet e saldimit dhe shtrimin e tubave.

Per konstruksionin e linjave te tubacioneve me nje presion operues maksimal te lejueshem deri ne 5 bar rekomandohet, qe 9do bashkim me saldim te protokollohet me ndihmen e nje aparati saldimi qe regjistron ne menyre te pavarur , ne perputhje me standardin perkates (Welding of thermoplastics- Heated tool welding of pipes, pipeline components and sheets made of PE).

Per nje presion operues maksimal te lejueshem me teper se 5 bar duhet qe bashkimet me saldim te protokollohen ne perputhje me standardin perkates, me ndihmen e nje aparati saldimi qe regjistron ne menyre te pavarur.

5.6.2 Kendet e kthimit/perkuljes

Kendet e perkuljes se tubave PE sipas tabeles 3 nuk duhet te tejkalohen. Per kende kthimi/perkulje me te vogla duhet te perdoren rakorderi te gatshme. Harqe te salduara me segmente nuk jane te lejuara.

Tabela 3 -Kendet e perkuljes

Kendi iperkuljes	Temperatura *e* montimit
50 xdn	
35 xdn	
20 xdn	20 ·C

E kushtezuar nga pro9edurat e punimeve, rezja e perkuljes per tubat PE 80 ose PE 100, ne gjendjen pa presion ne temperaturen 2o c ne perputhje me standardin DS CEN/TS 15223:2008 "Sistemet e tubave plastike, parametrat e vlefshem te projektimit per sistemet e tubave plastike nentokesore" mund te arrije vlerat e meposhtme per nje kohe te shkurter:

- SDR 17: $R_{min} = 15 \times d$
- SDR 11: $R_{min} = 10 \times d$

Per temperaturen o·c vlejne perkatesisht 2,5-fishi i vlerave. Midis temperaturave o c dhe 2o·c mund te interpolohet. Ne varesi te materialit, prodhuesi itubave mund te lejoje ne raste te ve9anta edhe vlera mete uleta.

5.6.3 Sigurimi icilesise se bashkimit me saldim

Saldimet duhet te kryhen ne perputhje me standardin perkates (Welding of thermoplastics -Heated tool welding of pipes, pipeline components and sheets made of PE) Aparatet e saldimit duhet te perputhen me kerkesat teknike te standardit perkates Welding of thermoplastics -Tools and devices for the heated tool welding of pipes and piping parts) (Per pergatitjen e siperfaqeve te tubave PE per saldimin me elektrofusion (HM) duhet te perdoren pajisje prerese apo qeruese. (madravide)

Kontrolli dhe vleresimi i bashkimeve me saldim mund te kryhet ne perputhje me standardin SSH EN 12007-2, shtojca B, ose sipas standardit perkates (Imperfections in thermoplastic welding joints - Features, descriptions, evaluation) Grupi ivleresimit I.

Qdo bashkim me saldim duhet te kontrollohet vizualisht.

Ne rastet e presionit operues maksimal te lejueshem deri ne e perfshi 5 bar, bashkimet rekomandohet te testohen me shkaterrim, ndersa ne rastet e presionit operues maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar ato duhet detyrimisht te testohen me shkaterrim, ne menyre rastesore.

Nje veshtrim te pergjithshem ne lidhje me pro9eduren e testimit pa shkaterrim dhe me shkaterrim mund te gjendet ne shtojcen E.

Nje rast te nje defekti ne forme si devijim nga kendi, ne raste te ve9anta me aprovimin e shoqerise mund te perdoret nje grup tjeter vleresimi.

Cilesia e pranueshme e bashkimeve me saldim te punuara ne kantier duhet te sigurohet nepermjet nje kontrolli te planifikuar nga mbikqyresit e saldimit te PE, ne perputhje me udhezimin GW 331. (Welding supervisor for weldings at PE-pipelines for gas and water supply-Training and examination schedule)

5.7 Instalimi ilinjes se gazit

Tubat dhe pjeset e tjera te linjes se tubacioneve te gazit duhet te pastrohen nga jashte dhe nga brenda, perpara se te vendosen ne kanalin e tubave, si dhe te kontrollohen per demtimet nga transporti dhe nga magazinimi. Ne rast se ka nderprerje te punimeve duhet te sigurohet, qe te mos depertoje uje apo lende te tjera ne tubacion.

Per zhytjen/uljen e tubave dhe segmenteve te veyante te tubave ne toke, duhet qe sipas rastit te kete pajisje ngritese ne numer te mjaftueshem, te cilat garantojne nje ulje te njetrajtshme dhe pa goditje te tubave, pa kaluar limitin e lejueshem te harkut te pe rkuljes (shiko kapitullin 5.6.2). Per mbrojtjen e tubave duhet te perdoren mjete ndihmese te pershtatshme (p.sh. rripa ose rrula).

Gjate uljes se linjes se gazit dhe gjate mbushjes se kanalit te tubacionit duhet te kemi parasysh, qe mundesisht te mbahen ne nje nivel sa me te ulet tensionet, p.sh. nga ndryshimet e temperaturave ne linjat e tubacioneve.

5.8 Mbushja e kanalit te tubit

Mbushja duhet te kryhet brenda nje kohe te shkurter mbas realizimit te bashkimit.

Linja e tubacioneve te instaluar duhet te jete e rrethuar nga te gjitha anet me nje trashesi shtrese te mjaftueshme me material dheu, perberja e madhesise se kokrrizave tete cilit duhet te jete e pershtatshme ne lidhje me rezistencen mekanike te tubave per krijimin e shtratit te pershtatshem per linjen e tubacioneve te gazit. Ne pergjithesi materiali nxjerre nga germimi mund te perdoret perseri per mbushjen e kanaleve te mbetura.

Ne rast se behen thellime te metejshme te nivelit te kanalit duhet qe sipas rastit, linja e tubacionit te kete nje shtrese te poshtme, ne menyre qe te mund te menjanohen tendosjet e palejueshme.

5.9 Montimi ipajisjeve bllokuese

Gjate montimit te pajisjeve bllokuese duhet te sigurohet, qe te mos lindin ngarkesa te papranueshme, ne rast nevoje duhet te mbrohen kundrejt fundosjes ose perdredhjes.

5.10Marktimi dhe matja

Linjat e gazit duhet te maten dhe te shenohen ne inventarin publik sipas standardit perkates (DIN 2425-1- Plans for public supplies, for water engineering and for transmision lines; plans for public pipe systems for gas and water supply, DIN 2425/3- Pians for Public Utilities, Water Resources and Long-distance Lines; Plans for Long-distance Pipelines,) si dhe ne dokumentimin dixhital te rrjetit sipas kodit te praktikave GW 120. Vendndodhja e pajisjeve te nevojshme bllokuese per operim duhet te marktohet me tabela sinjalizuese ne pE:hputhje me standardet perkatese (DIN 4065- Gas pipelines indicating labels), (DIN 4069 -Gas distribution grids indication labels). Jashte ndertimeve te mbyllura, ne perputhje me ecurine e trasese dhe te kushteve aktuale ne terren pikat e ve<;anta te orientimit, si p.sh. pikat e thyerjes ose kryqezimet, duhet te shenohen me tabela, shigjeta dhe gure dallues.

6. Testimi nen presion ne linjat e tubacioneve te gazit

6.1 Te pergjithshme

Pas mbushjes se kanalit te linjes se tubacioneve duhet qe para venies ne pune, linja e gazit ti nenshtrohet nje testimi ne presion te pergjithshem ose me segmente te caktuara, ne perputhje me pro<;edurat e pershkruara me kodin e praktikave G 469.

Eshte e rekomandueshme qe ndertimet e ve<;anta (p.sh. tub nenkalimi) perpara se te montohet ti nenshtrohet nje testimi te ve<;ante nen presion.

Shoqeria e ngarkuar me kryerjen e testimit nen presion duhet te perdore personel te mjaftueshem te kualifikuar, te besuar dhe te trajnuar.

Qe nga fillimi i venies nen presion deri ne uljen e presionit, pra mbas perfundimit te testimit nuk jane te lejueshme punimet ne linjen e gazit dhe ne zonat e aferta te linjes, per sa kohe qe nuk behet fjale per masa, te cilat jane te paevitueshme per kryerjen e testimit nen presion.

Mbas perfundimit te nje testimi nen presion me ajer duhet qe presioni te ulet ne menyre te kontrolluar dhe pa rrezik nepermjet pajisjeve te pershtatshme shfryrese.

6.2 Proyedurat

Per nje presion operimi maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar mund te perdoret vetem proyedura e matjes se presionit me uje (B 2) ose proyedura e matjes pneumatike preyize te presionit (C 3).

Testimi ne presion sipas kodit te praktikave G 469 paraqet vleren minimale te testimit nen presion; vlera maksimale nuk lejohet te jete me e madhe se vlerat e tabeles 4.

Tabela 4-Presionet testuese maksimale per linjat e tubacioneve te gazit prej polietileni

Seria e SDR	Diametri	PESO	PE 100	PE-X
SDR 17,6	75 mm :S:dn:S: 630 mm	4,1 bar	7,5 bar	-
SDR17	75 mm :S:dn:S: 630 mm	-	7,5 bar	-
SDR 11	dn:S: 630 mm	7,5 bar	15,0 bar	-
SDR 11	dn:S: 250 mm	-	-	12,5bar

Per nje presion operimi maksimal te lejueshem me te vogel ose te barabarte me 5 bar lejohet te perdoret vetem metoda e matjes se presionit me ajer (B 3).

Ne rast se kemi nje gjatesi linje deri ne 500 m lejohet te perdoret metoda e inspektimit vizual me ajer (A 3) ose metoda e inspektimit vizual me uje (A 2).

Ne rast se nuk ka mundesi tjeter, p.sh. ne bashkimet, mund te perdoret metoda e inspektimit vizual me gaz, me presion operues (A 4).

7. Certifikata e pranimit

Ne lidhje me rezultatin e testimit, leshohet nje yertifikate pranimi nga specialisti teknik ne rastin e linjave te tubacioneve me nje presion operimi maksimal te lejueshem me te vogel ose te barabarte me 5 bar dhe nga eksperti teknik, ne rastin e linjave te tubacioneve me nje presion operimi maksimal te lejueshem prej me shume se 5 bar.

Ne yertifikaten e pranimit (shiko shtojcen D) mbikqyrsi dhe drejtuesi i punimeve konfirmojne perputhshmerine ne baze te rregullave te linjave te tubacioneve te gazit sipas percaktimeve te ketij kodi te praktikave dhe personeli i kualifikuar/specialisti teknik ose eksperti teknik nuk kane asnje objeksion/rezerve ne lidhje me rezultatet e testimeve

nen presion, te kryera per venien ne pune te segmentit te linjes se testuar me presionin operues maksimal te lejueshem.

8. Venia ne pune

Ne rast nevoje, perpara se te vihet ne pune linja, duhet te pastrohet dhe ve9anerisht ne rast se i eshte nenshtruar nje testimi nen presion me uje, duhet te thahet me nje pro9edure te pershtatshme. Shkalla e tharjes varet nga kushtet e parashikuara te operimit (p.sh. lloji i gazit, temperatura dhe presioni i gazit).

Menjehere, para se te leshohet gazi ne linje duhet te konstatohet, se linjat e lidhjes ne rrjet jane te mbyllura hermetikisht dhe nuk mund te rrjedhe gaz i pakontrolluar. Pastaj linja duhet te mbushet me gaz dhe te vendoset ne operim duke respektuar kodin e praktikave G 465-2 ose G 466-1. Ne rast se eshte e nevojshme duhet te hartohet nje udhezim me shkrim i pro9edures.

9. Dokumentacioni

Dokumentacioni perbehet nga:

- Skicat e rregjistrimit
- Skicat dhe te dhenat teknike sipas kodit GW 120 (A)
- <;ertifikata e pranimit
- Protokollet e testimit nen presion
- Libri i tubacioneve
- Deshmite e testimit per tubat dhe rakorderite e tubave
-

Dokumentacioni duhet te jete idisponueshem gjate gjithe kohes se operimit te linjes.

Shtojca A (normative)- Masat shtese gjate perdorimit te materialeve te tjera plastike sipas Tabeles 1

A.1 Te pergjithshme

Konstruksioni i linjave me tuba te ndryshem nga tubat plastike te permendura ne tabelen 1 mund te kryhet ne menyre analoge sipas ketij kodi te praktikave. Per kete eshte e nevojshme te kemi nje konsulence te ve9ante inxhinierike. Per kete duhet te merren parasysh pikat e meposhtme.

A.2 Tubat dhe bashkimet/lidhjet

Tubacionet prej PE te perforcuar me fibra, duhet tu pergjigjen specifikimeve te testimit sipas standardit perkates. (RTP dhe bashkuesit perkates per linjat e gazit per presion operimi mbi 16 bar).

Pershtatshmeria e teknikes se bashkimit dhe ne rast nevoje dhe e bashkuesve duhet te deshmohet per sistemin ne perputhje me standardin perkates. Bashkuesit per tubat prej PE te perforcuar me fibra, rakorderite per tubat PE-X dhe bashkuesit 9elik-PE duhet te jene te 9ertifikuar dhe ti pergjigjen kerkesave te standardit perkates.

Nese nuk ekzistojne specifikime te testimit, duhet qe pershtatshmeria e tubave dhe e teknikes se bashkimit te deshmohet ne menyra te tjera, p.sh. nepermjet vleresimeve te ve9anta ose aprovimi nga prodhuesi i rakorderive ose i bashkuesve. Ne lidhje me presionin operues maksimal te lejueshem interpretimi mbeshtetet tek mekanizmi i defektit. Ne kete rast duhet te vendoset minimalisht faktori irrezikut 2.

A.3 Ndertimi

Per shkak te vetive te tubave dhe te komponenteve mund te jete i nevojshem ose i domosdoshem nje devijim nga masat dhe kerkesat teknike te pershkruara ne kapitullin 5. Kjo gje duhet te kontrollohet dhe devijimet duhet te dokumentohen. Nga kjo mund te preken p.sh. mbulimi minimal, teknika e bashkimit, kendet e perkuljes dhe mbushja e kanaleve te linjave dhe pusetat.

A.4 Testimi

Ne rast se metodat e testimit te presionit te pershkruara ne kapitullin 6 nuk jane te pershtatshme, duhet te merren parasysh kerkesat teknike ne perputhje me qellimin e mbrojtjes dhe te testimit. Menyra dhe parametrat e testimit nen presion duhet te percaktohen dhe te dokumentohen. Nepermjet testimit nen presion duhet te deshmohet hermeticiteti dhe nese eshte e mundur edhe qendrueshmeria ne lidhje me presionin operues maksimal te lejueshem, si dhe tejkalimet e mundshme te perkohshme ne kuadrin e sigurimit te presionit.

A.5 Masa te vecanta

Ve9anerisht per perdorimin pilot te sistemeve te tubave mund te percaktohen masa te ve9anta. Ne kete rast mund te behet fjale p.sh. per nje ngritje te shtreses mbuluese minimale ose te faktorit te sigurise, nje kontroll me i rrepte i bashkimeve ose per nje shkurtim te intervaleve te testimit te rrjeteve te tubacioneve. Per presionet maksimale operuese te lejueshme mbi 16 bar duhet te merret parasysh ne menyre te pershtatur kodi i praktikave G 463.

Shtojca B (normative) - Deshmite e testimit te pranimit 3.1 sipas standardit SSHEN 10204 per komponentet nen presionin operues maksimal te lejueshem mbi 5 bar

Per vetite e permendura ne Tabelen 8.1, ne lidhje me komponentet perkates, per sa kohe qe ato perdoren per presione operimi maksimale te lejueshme mbi 5 bar, duhet te paraqiten 9ertifikatat e pranimit sipas standardit SSH EN 10204, bazuar tek rregullat teknike te permendura ne paragrafin 4.3

Tabela 8.1 -Vetite e komponenteve qe duhen ertifikuar

	PE						Komponentet prej celiku dhe komponentet prej metali qe mbajne presion•	Hermeticiteti Qendrueshmeria Operimi
Tubat	X		X	X	X	X		
Rakorderite per saldimet koke me koke me ngrohje	X		X	X	X	X		
Rakorderite per saldimet me elektrofuzion	X	X	X	X	X	X		
Bashkimet PE/Celik	X	(X)	X	X	X	X	SSH EN 12007-3, SH EN ISO 3183°	
Pajisjet bllokuese	X		X	X	X	X		Sipas standardit perkates

a Emertimi i materialit, p.sh. CuZn 38 Pb3, PG-Grupi i testimit 3

b Deshmia nepermjet <;ertifikates se testimit te prodhuesit te materialit, perfshi hermeticitetin, stabilitetin termik dhe masa qe humbet nga ngrohja

c testimet qe duhen kryer mund te permbajne: analiza kimike, prova ne terheqje, prova ne perkulje (sharp) testimi teknologjik (prova e terheqjes, perdredhjes, ngjeshjes ose palosjes se unazes), testimi i presionit me uje, testimi pa shkaterrim i tegelave gjatesore (testimi me ultratinguj), inspektimi dhe testimi i permasave ne perputhje me kushtet teknike te furnizimit.

d Madhesia e lotit dhe numri i objekteve te testimit ne perputhje me kushtet teknike te furnizimit

Shtojca C (informative)- Shembull- libri i tubacioneve

Rruga: ---------- nga: ---------- deri: ---------- Nr. iporosise

se punes: _____ Presioni Max. i lejueshem:_____Data e shtrimit: ----------

Saldatori PE ---------- Nr. ideshmise.: Firma:

Aparati i saldimit: ---------- Nr.: Libri i tubacioneve:

Faqe: _____nga _____Faqe

Nr rendor i kompo nentit	Komponenti						Bashkimi				
									Te dhenat e matjes		
	Tubi [R] Rakor deria [F]	materi ali	gjatesi a e nderti mit m	diame tri i jashte m dn	Prodh uesi	Data e prodhi mit Nr.Ide nt.-	Lloji i bashki mit	Testimi i bashkim it	Temper atura e jashtme	Kush! et atmos ferike	

Impianti: Protokolli i testimit 0 po Shenime:

_____

Ojo

_____

Shtojca D (informative) -Shembull/ <;:ertifikata e pranimit

Kontraktuesi: ----------

2 Emertimi i linjes ----------

3 Emertimi i segmentit te linjes: ----------

4 Te dhena ne lidhje me segmentin e linjes

4.1 Gjatesia: _____

4.2 Materiali i tubit:----------

4.3 Diametri nominal i jashtem:----------

4.4 Raporti diameter-trashesi e murit (SDR): ----------

4.5 Presioni operues maksimal i lejueshem: ----------

5 Te dhena ne lidhje me punimet ne ndertimin e linjes

5.1 Shoqeria qe ka kryer punimet:----------

5.2 Lloji i lidhjeve te tubave: ----------

5.3 Numri i lidhjeve te tubave: ----------

5.4 Numri i lidhjeve te tubave te testuara: ----------

5.4.1 Lloji i testimit te lidhjeve/bashkimeve (me shkaterrim/pa shkaterrim):

_____

5.4.2 Testuarnga: _____

5.4.3 Vleresuar nga: _____

5.5 Punimet e linjes u mbikeqyren nga ----------

6 Testimi i segmentit te linjes

Proc;;eduar sipas kodit te praktikave G 469: ---------- Shenime: _____

Testimi nen presion u krye me sukses, nuk ka asnje objeksion kunder venies ne pune te segmentit te testuar te linjes me presionin operues maksimal te lejueshem. _____

Eksperti teknik/Specialisti teknik/personi i kualifikuar Vendi/Data

Shtojca E (informative)- Metoda e testimit per bashkimet me saldim

Tabela E.1 -Veshtrim i pergjithshem mbi proyedurat e testimit me dhe pa shkaterrim

Testime me shkaterrim		Testime pa shkaterrim	
Bashkim me saldim koke me koke me ngrohje	Saldim me elektrofuzion	Bashkim me saldim koke me koke me ngrohje	Saldim me elektrofuzion
Prova e perkuljes sipas standardit perkates ose Prova e terheqjes sipas standardit perkates	Prova ne prerje nepermjet perdredhjes sipas standardit perkates	Simetria e derdhjes se saldimit, Orientimi i tubave, Gjeresia e derdhjes se saldimit, Testimi i perkuljes te derdhjes se saldimit sipas EN 12007-2 (Shtojca B) dhe EN 16296.	Orientimi i tubave, Thellesia e depertimit, Dalja e materialit shkrires sipas EN 12007-2 (Shtojca B) dhe EN 16296
Perzierje me material te huaj, Poret, zgavra sipas EN 16296	Perzierje me material te huaj, Poret sipas EN 16296	<;;arje, goditje, gervishtje sipas EN16296	Pershtashmeria e formes sipas EN16296

10.Bibliografi

10.1Kodet e praktikave te DVGW

G 100 (A), Kerkesat teknike per kualifikimin e eksperteve teknike te DVGW-se per furnizimin me gaz

G 260 (A), Cilesia e gazit

G 414 (A), Linjat e gazit te instaluara ne toke

G 457 (A), Rritja e mevonshme e presionit ne linjat e gazit prej polietileni (PE 63, PE 80, PE 100)

G 465-2 (A), Linjat e gazit me nje presion operimi deri 5 bar- Riparimet.

G 466-1 (A), Linjat e gazit me tuba 9eliku per nje presion operimi mbi 5 bar; mirembajtja

G 463 (A), Linjat e gazit me tubacione c;:eliku me nje presion operimi mete madh se 16 bar- Konstruksioni

G 469 (A), Metodat e testimit nen presion per transmetimin e shperndarjen e gazit. G

474 (H), Masat per operimin e sigurt te linjave te tubacioneve te gazit ne zonat te influencuara nga aktivitetet minerare.

G 491, Impiantet e rregullimit te presionit te gazit per presionet hyrese deri ne e perfshi 100 bar; projektimi, fabrikimi, ndertimi, testimi, komisionimi dhe operimi.

G 614 (A), Linja te gazit te instaluara ne ndertimet/zonat industriale, mbas pikes se hyrjes. GW

120 (A), Dokumentimi i rrjeteve ne shoqerite e furnizimit

GW 125 (H), Pemet, linjat nentokesore dhe kanalet

GW 301 (A), Kriteret e kualifikimit per shoqerite e ndertimit te linjave te tubacioneve

GW 302 (A), Kriteret e kualifikimit per instalimet e reja pa kanale dhe rehabilitimin e linjave te tubacioneve qe nuk jane ne operim

GW 304 (A), Avancimi itubave(pipe jacking) dhe metodat e ngjashme (pro9eset e lidhura mete)

GW 315 (H) Udhezime per masat mbrojtese te impianteve te furnizimit gjate punimeve te ndertimit

GW 320-1 (A), Rehabilitimi i linjave te tubacioneve te gazit dhe ujit nepermjet metodes *PE-Relining (tub ne* tub)- Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi

GW 320-2 (A), Rehabilitimi i linjave te tubacioneve te gazit dhe ujit nepermjet metodes *PE-Relining(tub ne* tub)- Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi

GW 321 (A), Metoda e drejtuar horizontalisht e shpimit me shpelarje per linjat e tubacioneve te gazit dhe uji */* Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi

GW 322-1 (A), Nderrimi pa hapje kanali i linjave te tubacioneve te gazit dhe ujit-Pjesa 1: Metoda me shtypjelterheqje; Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi.

GW 322-2 (A), Nderrimi pa hapje kanali i linjave te tubacioneve te gazit dhe ujit-Pjesa 2: Metoda me tub ndihmes; Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi.

GW 323 (M), Rinovimi pa hapje kanali i linjave te tubacioneve te gazit dhe ujit nepermjet metodes, *Burst-lining-* Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi.

GW 324 (A), Metoda me frezim dhe metoda me plug per linjat e tubacioneve te gazit dhe ujit */* Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi.

GW 325 (A), Menyrat e ndertimit pa kanale per linjat bashkuese te gazit dhe ujit - Kerkesat teknike, sigurimi icilesise dhe testimi.

GW 330 (A), Saldimi itubave dhe pjeseve te linjave te tubacioneve prej polietileni (PE 80, PE 100 und PE-Xa) per linjat e tubacioneve te gazit dhe ujit -Plani itrajnimit dhe testimit.

GW 331 (M), Mbikqyrja e saldimit ne linjat e tubacioneve prej PE-HD per furnizimin me gaz dhe me uje- Plani itrajnimit dhe testimit

GW 332 (M), Shtypja e linjave te tubacioneve prej polietileni ne shperndarjen e gazit dhe te ujit

GW 335-A2 (A), Sistemet e linjave te tubacioneve plastike ne shperndarjen e gazit dhe te ujit, Kerkesat teknike dhe Testimet, Pjesa A2: Tubat prej PE 80 dhe PE 100

GW 335-A3 (A), Sistemet e linjave te tubacioneve plastike ne shperndarjen e gazit dhe te ujit, Kerkesat teknike dhe Testimet, Pjesa A3: Tubat prej PE-Xa

GW 335-82 (A), Sistemet e linjave te tubacioneve plastike ne shperndarjen e gazit dhe te ujit, Kerkesat teknike dhe Testimet, Pjesa 82: Rakorderite prej PE 80 und PE 100

VP 302 (P), Valvolat bllokuese prej polietileni (PE 80 und PE 100)- Kerkesat teknike dhe testimet

VP 304 (P), Valvolat shpuese te gazit me bllokues operimi te inkorporuar per linjat e tubacioneve te polietilenit (PE 80, PE 100, PE-Xa) -Kerkesat teknike dhe testimet

G 5600 (P), 8ashkuesit e ndryshimit te materialit prej metali per linjat e tubacioneve te gazit prej polietileni; Kerkesat teknike dhe testimet

VP 640 (VP), Sistemet e linjave te tubacioneve plastike ne shperndarjen e gazit dhe te ujit -Kerkesat teknike dhe testimet per tubat prej PE-Xb dhe PE-Xc

VP 642 (P), Tubat PEte perforcuar me fibra (RTP) dhe bashkuesit perkates per linjat e gazit me presioni operimi mbi 16 bar

10.2Standardet DIN

DIN 2425-1, Plani per ekonomine e furnizimit, ekonomine e ujit dhe furnizimet ne distanca te largeta; planet e rrjetit te tubacioneve te sistemeve publike te furnizimit me gaz dhe me uje

DIN 2425-3, Plani per sherbimet publike , menaxhimin e ujit dhe per furnizimet ne distanca te largeta; planet per rrjetet e tubacioneve.

DIN 3543-4, Valvolat e shpimit prej polietileni me dendesi te larte (HOPE) per tubat prej HOPE; Permasat

DIN 4065, Gazsjellesat- Tabelat sinjalizuese

DIN 4069, Tubacionet lokale te shperndarjes se gazit - Tabelat sinjalizuese

DIN 4124, Gropat e ndertimit dhe kanalet; rrepirat, punimet ndertuese, gjeresia e hapesires se punes.

DVS 2202-1, Defektet ne bashkimet me saldim te termoplastikave; Tiparet, pershkrimi, vleresimi.

DVS 2207-1, Saldimi itubave plastike- Saldimi ielementeve te tubave ne te nxehte, pjeseve perberese te tubave dhe panelet prej HOPE.

DVS 2208-1, Saldimi itubave plastike- Makinerite dhe pajisjet per saldimin koke me koke te elementeve te tubave ne te nxehte, pjeseve te linjave te tubacioneve dhe paneleve.

Referencat e tabeles E.1

DVS 2202-1_1mperfections in thermoplastic welding joints - Features, descriptions, evaluation; Imperfections in thermoplastics welded joints -Quality levels; German version EN 16296:2012

DVS 2203-2_Testing of welded joints between panels and pipes made of thermoplastics - Tensile test ISO 37

DVS 2203-5_Testing of welded joints of thermoplastics plates and tubes -Technological bend test.

DVS 2203-6 _Testing of joints between polymeric materials- Shear and peeling tests

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ENERGJISE
DHE INDUSTRISE

DVGW

Rregullat Teknike per Industrine e Gazit

Kodi i praktikave GW 20-Shkurt 2014



Autorizuar nga DVGW

Mbrojtja katodike nga korrozioni ne tubat mbrojtes ne zonat e kryqezimeve me rruget e transportit, tubat prej c;eliku te produktit ne proc;eduren me shtytje

Pershtatur nga Ministria Energjise dhe Industrise (MEI) Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit te Hidrokarbureve www.energjia.gov.al

TIRANE 2016

Parathenie

Rregullat Teknike per Industrine Shqiptare te Gazit jane pergatitur nga Ministria e Energjise dhe Industrise (MEI), ne zbatim te kerkesave te ligjit nr. 102/2015, date 23.09.2015, "Per sektorin e gazit natyror", si pershtatje e Rregullave Teknike per Industrine e Gazit te Shoqates Shkencore e Teknike Gjermane per Gazin e Ujin (DVGW). Pershtatja e ketyre Rregullave Teknike per Industrine Shqiptare te Gazit eshte realizuar nga Grupi i Eksperteve te MEI per Rregullat Teknike te Gazit, prane Drejtorise se Politikave dhe Zhvillimit te Hidrokarbureve, ne bashkepunim me DVGW ne kuader te projektit "Perkthimi dhe pershtatja e Rregullave Teknike per Sektorin Shqiptar te gazit" i cili eshte financuar nga nje fond dhene nga Qeveria Zviceriane ne kuader te Marreveshjes per ngritjen e kapaciteteve ne sektorin e gazit ratifikuar me ligjin nr. 58/2015, date 28.5.2015, "Per ratifikimin e marreveshjes ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Konfederates Zvicerane per Grantin e Asistences Financiare per projektin "Ngritja e kapaciteteve per zhvillimet ne permasa te medha te infrastruktures se gazit ne Shqiperi, II".

Pergatitja e tyre eshte perballur me sfiden e pershtatjes se referencave te dokumentacionit origjinal ne legjislacionin Gjerman ne fuqi me legjislacionin perkates ne Shqiperi. Ne rrethanat kur legjislacioni perkates ne Shqiperi ende nuk eshte plotesuar, permendja e parimeve baze ka zevendesuar pamundesine e referencave specifike ne legjislacionin shqiptar.

Ky rregull teknik eshte bazuar ne dokumentin origjinal te kuadrit rregullator te rregullave teknike te DVGW-GW 20, "Kathodischer Korrosionsschutz in Mantelrohren im Kreuzungsbereich mit Verkehrswegen Produktrohre aus Stahl im Vortriebsverfahren" botimi i Shkurtit 2014.

Pershtatja dhe perpunimi i tij eshte kryer nga Grupi i Eksperteve te ME I per Rregullat Teknike te Gazit, ne bashkepunim me eksperte te DVGW:

Dr. Ing. Jochen Adam	- ekspert iDVGW
Ing. Besnik Bozgo	- koordinator iGrupit Shqiptar te Eksperteve
Ing. Ilir Metaj	- specialist
Ing. Arben Tare Ing.	- specialist
Arbi Murataj	- specialist
Z. Florenc Qosja	- perkthyes iautorizuar iDVGW

Proyedura e aplikuar ne kete projekt eshte si me poshte:

Permbajtja teknike e ketij dokumenti nuk eshte ndryshuar ne raport me dokumentin baze. (burimor)

Ndryshime qe nuk ndryshojne permbajtjen teknike, por qe jane te qenesishme per zbatimin e ketij dokumenti.

Rregullat teknike te DVGW ne tekstin e kesaj rregulloreje teknike kane te bejne vetem me germen "G" (gaz) ose "GW" (gaz dhe uje) si dhe numrin perkates.

Standardet ISO dhe EN jane standardet nderkombetare dhe europiane te adoptuara si standarde shqiptare nga Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit ne Shqiperi. (DPS)

Ne dokument jane vene shenime ne fund te faqes per spjegimet e nevojshme lidhur me aktet nenligjore burimore apo ndryshime te paraqitjes se organeve qertifikuese ne raport me tekstin baze (burimor). Ne proqeduren e harmonizimit te ketij dokumenti, ligjet e cituara ne tekstin baze (burimor) jane zevendesuar me ligjet respektive shqiptare.(kur ato egzistojne)

Me qellim te harmonizimit me te rejat me te fundit te industrise e teknikes ky Rregull Teknik do te perditesohet rregullisht bazuar ne ndryshimet dhe plotesimet aktuale te kryera ne standardet europiane dhe shqiptare.

Ne pergatitjen e ketij rregulli teknik eshte marre autorizimi nga DVGW-ja dhe ai eshte miratuar ne takimin e Keshillit koordinues te projektit "Perkthimi dhe Pershtatja e Rregullave Teknike per Sektorin Shqiptar te Gazit" date:22.05.2014

Koordinatore e Projektit nga DVGW

Dipl.- GDFS Znj. Hiltrud Schuelken

Koordinator iProjektit nga MEI

Prof. As. Dr. Stavri Chima

Tiranedate: .09.08.2016

Hyrje

Nga kendveshtrimi teknik i mbrojtjes nga korrozioni ky rregull permban udhezime per projektimin, venien ne pune dhe monitorimin teknik te nje linje produkti te mbrojtur nga ana katodike, e cila eshte instaluar brenda nje tubi mbrojtes. (me veshje, me mantel)

Per perpunimin e ketij kodi te praktikave kane qene percaktuese mendimet e meposhtme:

- Perve9 tubave mbrojtes prej 9eliku ne praktike perdoren shpesh edhe tubat mbrojtes te perbere nga plastike, beton, ose betonarmeje. Keto materiale merren parasysh ne perpunimin e meposhtem te kE:Hij kodi ne lidhje me ndikimet e tyre ndaj mbrojtjes nga korrozioni te tubit te produktit.

- Trajtimi indikimit te nje tubi mbrojtes mbi rrezikun e korrozionit te shkaktuar nga rryma alternative ne tubin e produktit.

- Reflektimi ne kete kod te praktikave i eksperiencave me materialet mbushese prej crimentoje dhe prej plastike per hapesiren unazore.

- Per vleresimin e mbrojtjes katodike nga korrozioni te tubit te produktit nderkohe ekzistojne njohuri te reja te cilat pershkruhen ne menyre me te detajuar ne riperpunimin e ketij kodi.

- Duke konsideruar argumentet ne lidhje me specifikimet ne Kodin e praktikave GW 27, jane pershtatur rregullat e matjes per testimin e mbrojtjes katodike te tubacioneve, te cilat jane instaluar me procredura shtrimi pa hapje kanalesh.

- Duhej te hartoheshin masa, te cila duhet te merren ne konsiderate, ne rastet kur mbrojtja katodike nga korrozioni e tubit te produktit nuk eshte mjaftueshmerisht e efektshme ne tubin mbrojtes.

Gjithashtu ne kete kod te praktikave u perfshine udhezime per kontrollin e cilesise se mbeshtjelljes se nje tubi produkti, i cili eshte futur ne nje tub mbrojtes, ne kuadrin e masave te reja rikonstruktuese. Kjo gje u konsiderua si e domosdoshme, pasi ka pasur disa raste ne te shkuaren, kur gjate proyesit te futjes se tubave jane konstatuar pika me defekte ne mbeshtjelljen e tubit te produktit.

1 Fusha e perdorimit

Ky kod i praktikave vlen per mbrojtjen katodike nga korrozioni (MKK) te tubave te produktit brenda tubave mbrojtes prej 9eliku, plastike dhe beton armeje, ose per tubat e produktit, te cilat jane shtruar me metoden e shtytjes pa kanale. (trenchless technology)

Ky kod i praktikave jep informacion per planifikimin, ven1en ne pune (komisionimin) dhe monitorimin teknik te matjeve te MKK te linjes se produktit.

2 Standardet referuese

Dokumentet e cituara me poshte jane te domosdoshme per perdorimin e ketij Kodi. Per referencat me date, vlen dhe zbatohet vetem botimi i cituar ndersa per referencat pa date, vlen dhe zbatohet botimi me ifundit idokumentit referues.

SSH EN 10289 Tubat dhe rakorderite e 9elikut per linjat e tubacioneve te shtrira nen toke dhe ne uje (onshore dhe offshore) - Mbeshtjelljet (shtresezim i jashtem) me materiale epoksidi dhe te modifikuara me epoksid.

SSH EN 10290 Tubat dhe rakorderite e 9elikut per linjat e tubacioneve te shtrira ne toke dhe ne uje (Onshore dhe offshore) - Mbeshtjellje (shtresezim i jashtem) me materiale poliuretani dhe te modifikuara me poliuretan.

SSH EN 12068 Mbeshtjelljet e jashtme organike per mbrojtjen nga korrozioni te linjave te tubacioneve prej 9eliku, te shtrira ne n toke dhe te zhytura ne uje, qe perdoren te lidhura me mbrojtjen katodike -Shiritat ngjites dhe materialet qe tkurren.

SSH EN 12954 Mbrojtja katodike nga korrozioni *e* strukturave metalike nen toke dhe te zhytura ne uje- parimet e pergjithshme dhe aplikimi ne linjat e tubacioneve.

3 Simbolet, njesite matese dhe shkurtimet

Rm; Pjese e rezistences elektrike te perhapjes te pikave me defekt ne mbeshtjellje ne tubin e produktit brenda tubit mbrojtes, ne lenden qe ndodhet ne hapesiren unazore (gjithashtu permban edhe rezistencen e mbeshtjelljes se veshjes se brendshme ekzistuese, te tubit mbrojtes nese ekziston)

